

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5452  
E hënë, 16 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## TE NËNË DRITA E BEDRI ISLAMIT

FAQE 12



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**PACOLLI KËRKON NGA  
IZRAELI TA NJOHË KOSOVËN**

F. 3

**NIS NDËRTIMI I  
AUTOSTRADËS PRISHTINË -  
GJILAN - DHEU I BARDHË**

F. 7

**LV-ja: PUSHTETI I  
PARABURGOSI STUDENTËT E  
SKV-së, QË TË MOS DËGJOHEJ  
RRËFIMI I TYRE**

F. 5

**MINISTRI TAHIRI:  
DO TË RRIETET NUMRI I  
PËRMBARUESVE PRIVATË**

F. 11

### EKONOMI

**GAP-i: ME TC 'KOSOVA E RE'  
RRYMA SHITJESË PËR  
40 PËR QIND**

F. 8

### KULTURË

**MË 19 PRILL BËHET HAPJA E  
EKSPOZITËS SË PIKTORIT  
DEMUSH AVDIMETAJ**

F. 14

### SPORT

**PRISHTINA S'I NDAHET  
DRITËS; '89-SHI, BINDËS  
NDAJ VËLLAZNIMIT**

F. 16

**BASHKIMI MPOSHTET NGA  
LEVSKI NË FINALE TË LIGËS  
BALLKANIKE**

F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", BESNIK TAHIRI

FAQE 4-5

## Reforma shtetërore të jetë e guximshme dhe strategjike

### - Nuk do të ketë koncesione për asociacionin

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka kërkuar që reforma shtetërore të jetë e guximshme, afatgjatë dhe strategjike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka pranuar se administrata në vendin tonë ka të meta. Sipas tij, ka shumë pabarazi në hierarki institucionale, funksione publike dhe në paga. Tahiri ka folur edhe për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, duke thënë se nuk do të ketë kurrfarë koncesionesh në këtë proces. Sipas tij, asociacioni do të jetë në plotësi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Drafti apo statuti që do të hartohet do t'i dërgohet për vendim final Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e cila do ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij", ka thënë Tahiri

## LDK-ja kërkon marrëveshje në mes të partive për zgjedhje të parakohshme

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kërkuar arritjen e një marrëveshjeje në mes të partive politike për punët që duhen kryer deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së,

Avdullah Hoti, ka thënë të dielën se çdo ditë e humbur pa një marrëveshjeje të tillë është rrezik dhe humbje për Kosovën. Ai ka theksuar se koalicioni qeverisës e ka humbur shumicën në Kuvend. Ndërsa përfaqësuesit e koa-



licionit qeverisës kanë thënë se Qeveria e ka shumicën e nevojshme në Kuvendin e Kosovës, prandaj do ta vazhdojë mandatin



## Industria e drurit dhe e minierave, tërheqëse për investitorët e huaj

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Besian Mustafa, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se në mesin e sektorëve më atraktivë për investitorët e huaj në

Kosovë janë industria e drurit, përpunimi i ushqimit, përpunimi i metalit, përpunimi i tekstilit, turizmi, energjia dhe minierat. Ai ka thënë se stabiliteti politik është ndër faktorët më të rëndësishëm për tërheqjen e investimeve të huaja

FAQE 8

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çarëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GRUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kryeministri bullgar sot në Kosovë

PRISHTINË, 15 PRILL - Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, shtet ky që aktualisht kryeson Presidencën e Bashkimit

Evropian, sot (e hënë) vjen në Kosovë. Ardhja e tij është bërë me ftesë të presidentit të vendit, Hashim Thaçi, i cili ditë më parë kishte zhvilluar një bisedë

telefonike me të ku, ndër të tjera, kishin folur edhe për Samitin e Sofjes, që vlerësohet i rëndësishëm për rrugëtimin e shteteve të Ballkanit

Perëndimor drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Borissov do të takohet edhe me kryeparlamentarin Veseli dhe kryeministrin Haradinaj.



## Arrestimi i Gjuriqit përplas Veselin me homologen serbe



Arrestimi i Marko Gjuriqit ishte bërë shkas që kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Maja Gojković, të përplasen me deklarata në një takim rajonal në Lubjanë

PRISHTINË, 15 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Maja Gojković, janë përplasur me deklarata në Lubjanë të Sllovenisë për rastin e arrestimit dhe deportimit të Marko Gjuriqit, i cili u fut ilegalisht në Kosovë.

Kryetarja e Parlamentit serb e shfrytëzoi fjalën e saj në punimet e Sesionit të pestë plenar të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore ku ishin të pranishëm kryeparlamentarë të vendeve të rajonit, për t'u ankuar se Kosova e ka arrestuar zyrtarin e lartë serb. "Dialogu me Prishtinën po vazhdon tash e

pesë vjet, por më duhet të theksoj se ndodhi një incident i rëndë, ku është arrestuar një nga pjesëmarrësit e dialogut, Marko Gjuriqi", tha kryekuvendarja serbe duke u munduar ta paraqesë rastin e Gjuriqit si veprim të parregullt nga ana e institucioneve kosovare.

Por i menjëhershëm ka qenë reagimi i kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili tha se Gjuriqi ka qenë disa herë në Kosovë, natyrisht duke marrë leje ndërsa, sipas Veselit, Marko Gjuriqi është dëbuar pasi është futur në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë ilegale. "Për rastin e Gjuriqit, të cilin e përmendën kolegët nga Serbia,

neve na vjen keq, shpresojmë që në të ardhmen të mos ndodhë më, por Kosova është shtet i pavarur, andaj duhet respektuar ligjet dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Gjuriqi si zyrtar i lartë i Serbisë, ka qenë disa herë në Kosovë. Ai është i mirëseardhur në Kosovë sa herë që të dojë, por që duhet t'i respektojë institucionet, pra të marrë leje për të hyrë në Kosovë. Pra, në rastin në fjalë ai erdhi në Kosovë në mënyrë ilegale, nuk respektoi autoritetet shtetërore, bëri përpjekje për të krijuar kriza që kanë qenë të panevojshme, andaj ai nuk është arrestuar, por është dëbuar nga shteti i Kosovës", ka thënë Veseli.

## KE-ja rekomandon çeljen e negociatave për Shqipërinë

BERLIN, 15 PRILL - Komisioni Evropian do ta rekomandojë çeljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Lajmi konfirmohet nga "Westdeutsche Allgemeine Zeitung" (WAZ), një gazetë prestigjioze gjermane me qendër në Essen dhe që publikohet nga grupi mediatik Funke Mediengruppe, e cila zbardh pjesë të progresraportit të Komisionit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Negociatat e anëtarësimit pritet të fillojnë me Shqipërinë dhe Maqedoninë, citon WAZ.

"Raportet e progresit për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë siguruar nga redaksia jonë, nënvizojnë perspektivën e anëtarësimit të këtyre vendeve

në Bashkimin Evropian, por ndërkohë Komisioni bën thirrje për reforma më të mëdha", thuhet në këtë shkrim.

Negociatat e anëtarësimit, vijon gazeta, aktualisht po zhvillohen me Malin e Zi dhe Serbinë, por Komisioni kërkon t'i zgjerojë më tej dhe, në kuadër të progresit të arritur, ka rekomanduar hapjen e bisedimeve të anëtarësimit edhe me Maqedoninë e Shqipërinë.

Ndërkohë Komisioni i BE-së vazhdon ta përjashtojë pranimin e Turqisë si anëtare të BE-së. "Turqia ka ndërmarrë hapa të mëdhenj larg Bashkimin Evropian", thuhet në raportin për përparimin e Turqisë në lidhje me gjendjen e negociatave të anëtarësimit", citon "Deutsche Welle".



## Mali i Zi të dielën ka zgjedhur presidentin

PODGORICË, 15 PRILL - Rreth 530 mijë votues në Mal të Zi kanë vendosur të dielën së kush do të jetë presidenti i vendit të vogël në bregun e Adriatikut për pesë vjet. Sipas anketave, kandidati i Partisë Demokratike të Socialistëve pro evropian, Milo Gjukanoviç, gëzon mbështetjen e mbi 50 për qind të votuesve. Ndërsa Mladen Bojaniç, një afarist i mbështetur nga një aleancë e partive opozitare, përfshirë edhe disa që dëshirojnë lidhje më të ngushta me Rusinë, mund të marrë rreth 30 për qind të votave.

Zgjedhjet parlamentare të vjeshtës së vitit 2016 kaluan nën hijen e arrestimeve të një grupi nacionalistësh serbë të dyshuar për përfshirje në një komplot për vrasjen e Milo Gjukanoviçit dhe vënien në pushtet të partive pro ruse, për ta penguar anëtarësimin e Malit të Zi në NATO.

Moska i ka hedhur poshtë pohimet për mbështetje të përpjekjeve për grushtshtet, por nuk ka fshehur kundërshtimin e saj ndaj anëtarësimit të Malit të Zi në NATO.

Mali i Zi u është bashkuar sank-

sioneve evropiane ndaj Moskës në vitin 2014, ndërsa muajin e kaluar Podgorica dëboi një diplomat rus pas helmimit të ish-agentit rus në Britani.

Në vitin 2016 Milo Gjukanoviç dha dorëheqje nga posti i kryeministrit, ndërsa muajin e kaluar shpalli vendimin për t'u rikthyer në pushtet për shkak të përgjegjësisë për të ardhmen e Malit të Zi. Kundërshtari i tij e akuzoi Gjukanoviçin për korrupsion e lidhje me krimin e organizuar.

Zgjedhjet e së dielës janë të parat që kur vendi u bashkua me



NATO-n dhe shihen si një provë për orientimin evropian të vendit. Milo Gjukanoviç dhe partia e tij

drejtajnë vendin për gati tridhjetë vjet. Në vitin 2006 Mali i Zi shpalli pavarësinë.

# LDK-ja kërkon marrëveshje në mes të partive për zgjedhje të parakohshme

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kërkuar arritjen e një marrëveshje në mes të partive politike për punët që duhen kryer deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë të dielën se çdo ditë e humbur pa një marrëveshje të tillë është rrezik dhe humbje për Kosovën. Ai ka theksuar se koalicioni qeverisës e ka humbur shumicën në Kuvend. Ndërsa përfaqësuesit e koalicionit qeverisës kanë thënë se qeveria aktuale e ka shumicën e nevojshme në Kuvendin e Kosovës dhe, si e tillë, do ta vazhdojë mandatin e saj

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, u ka bërë thirrje të dielën partive të tjera politike që t'i bashkohen nismës së këtij subjekti për një tryezë të përbashkët për t'u pajtuar për tejkalimin e situatës së krijuar në vend. Sipas tij, tashmë koalicioni qeverisës e ka humbur shumicën në Kuvendin e Kosovës. "Situata e re e krijuar në vend, me humbjen e shumicës parlamentare nga partitë në pushtet, kërkon t'i kapërcejmë interesat e ngushta politike. LDK-ja është e vendosur dhe e pakompromis në ruajtjen e rendit kushtetues dhe demokracisë në Kosovë. Ne presim nga partitë e tjera t'i bashkohen nismës sonë për një tryezë të përbashkët për t'u pajtuar për tejkalimin e situatës. Koalicioni qeverisës e ka humbur shumicën në Kuvendin e Kosovës", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se tani koalicioni ka vetëm 52 vota në Kuvend, ndërsa partitë opozitare kanë 68 vota. Sipas Hotit, ky koalicion i pakicës nuk ka

legjitimitet për të qeverisur. "Tani koalicioni ka vetëm 52 vota në Kuvend, ndërsa partitë opozitare kanë 68 vota. Partitë opozitare të shumicës shqiptare në Kuvendin e Kosovës numërojnë 385 mijë vota. Ndërsa, partitë shqiptare të koalicionit qeverisës numërojnë 245 mijë vota. Prandaj, është e qartë se ky koalicion i pakicës nuk ka legjitimitet për të qeverisur", është shprehur Hoti, duke shtuar se partitë politike duhet të arrijnë një marrëveshje për punët që duhen kryer bashkërisht deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Sipas tij, çdo ditë e humbur pa një marrëveshje të tillë është rrezik dhe humbje për vendin. "Çdo ditë e humbur pa një marrëveshje në mes të partive politike për punët që duhen kryer bashkërisht deri në zgjedhjet e parakohshme është rrezik dhe humbje për Kosovën", ka deklaruar Hoti.

Ndërsa përfaqësuesit e koalicionit qeverisës kanë thënë se Qeveria aktuale e ka shumicën e nevojshme në Kuvendin e Kosovës dhe, si e tillë, do ta vazhdojë mandatin e saj. Nënkrjetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh zëvendës-



ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë se Lista Serbe ende është pjesë e koalicionit qeverisës. Sipas tij, veprimet e këtij subjekti politik janë vetëm lojëra politike. "Kjo Qeveri do të jetë gjatë në detyrë, sepse mendojmë se Qeveria e ka shumicën e nevojshme. Me siguri se e kemi parë që ministrat e Listës Serbe dalin në punë, kurse lojërat politike nuk mund t'i komentoj", është shprehur Matoshi. Ai ka mohuar mundësinë që shkarkimi i ministrit të Punëve të Brendshme ta ketë dëmtuar partneritetin mes kësaj partie dhe kryeministrit Haradinaj. "Ne nuk kemi qenë të kënaqur me kërkesën e kryeministrit që z. Sefaj ta lironte detyrën. Kjo

kërkesë ka qenë e padrejtë, mirëpo kjo nuk e ka dëmtuar partneritetin tonë. E kemi thënë edhe më herët, se AKR-ja e ka bërë këtë Qeveri. AKR-ja e ka shpëtuar edhe tash këtë Qeveri. Natyrisht se AKR-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar që kjo Qeveri ta çojë deri në fund mandatin", ka thënë Matoshi.

Por e pakënaqur me punën e Qeverisë është shprehur ish-zëvendëskryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, duke thënë se nuk ka qeverisje vizionare dhe vendimmarrëse. Sipas saj, edhe kur janë marrë vendimet, shumica prej tyre kanë përfunduar në Gjykatën Kushtetuese. "Nuk po shoh një qeverisje vizionare dhe vendimmarrëse. Edhe kur janë marrë

vendimet, shumica prej tyre kanë përfunduar në Gjykatën Kushtetuese. Me vjen mirë që demarkacioni është miratuar sepse ka hapur rrugën për lëvizjen e lirë të qytetarëve në Evropë. Mirëpo, në përgjithësi, nuk po shoh ndonjë kapacitet të kësaj Qeverie përballë përgjegjësive që ka për shtetin dhe qytetarët. Kemi Qeveri të pakicës, në anën tjetër as opozita nuk e ka shumicën për ta rrezuar, pra është pat pozicion. Kjo mund t'i zgjasë jetën Qeverisë, por nuk u shërben qëllimeve madhore, si: përshejtim të reformave evropiane, krijimit të ushtrisë, obligimeve në luftën kundër korrupsionit dhe të tjera", ka thënë Tahiri për "Epokën e re".

## Pacolli kërkon nga Izraeli ta njohë Kosovën

**PRISHTINË, 15 PRILL (ER)** - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, u ka dërguar urime përfaqësuesve të shtetit të Izraelit me rastin e shënimit të vitit jubilar të 70-vjetorit të Pavarësisë, ndërkohë që i ka bërë thirrje edhe një herë për rishqyrtimin e njohjes de jure të Pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin e dhjetë të ekzistencës së saj si shtet i pavarur dhe sovran. "Në këtë vit të veçantë të shënimit të 70-vjetorit të Pavarësisë, dëshiroj t'i dërgoj urimet më të sinqerta popullit dhe liderit të shtetit të Izraelit. Bashkëjetesa dhe harmonia në mes të shqiptarëve të

Kosovës dhe hebrenjve ka gjurmë historike shekullore në vendin tonë, duke përfshirë edhe periudhën e lavdishme të ndihmës në shpëtimin e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Marrëdhëniet në mes dy vendeve tona kanë shënuar ngritje të vazhdueshme edhe në nivelin institucional që nga shpallja e pavarësisë sonë dhjetë vjet më parë, por ky mund të jetë një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi shqyrtimin e njohjes edhe de jure të Kosovës. Presim që në të ardhmen e afërt të kemi përfaqësim të Kosovës në Izrael", ka thënë Pacolli në urimin e tij.



Flet për "Epokën e re", Besnik Tahiri

# Reforma shtetërore të jetë e

## - Nuk do të ketë koncesione për asociacionin

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka kërkuar që reforma shtetërore të jetë e guximshme, afatgjatë dhe strategjike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka pranuar se administrata në vendin tonë ka të meta. Sipas tij, ka shumë pabarazi si në hierarki institucionale, funksione publike dhe në paga. Tahiri ka folur edhe për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, duke thënë se nuk do të ketë kurrfarë koncesionesh në këtë proces. Sipas tij, asociacioni do të jetë në plotësi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Drafti apo statuti që do të hartohet do t'i dërgohet për vendim final Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e cila do ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij", ka thënë Tahiri

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka deklaruar se reformat shtetërore duhet të jenë të guximshme, afatgjatë dhe strategjike. Ai ka pranuar të metat në administratën shtetërore, duke thënë se ka shumë pabarazi në hierarkinë institucionale, funksione publike dhe në paga. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë proces duhet të ndërtohen themelet e qëndrueshme që do të shërbejnë për zhvillim të qëndrueshëm në dekadën e dytë të shtetësisë. "Qëndrimi im është të kemi guxim si shoqëri dhe qeveri për t'i parë të metat dhe për të sugjeruar një bazë të qëndrueshme të sistemit qeverisës në vend. Për fat keq, ka shumë pabarazi si në hierarki institucionale, funksione publike e shtetërore, po

ashtu edhe në paga. Për këtë arsye vizioni i këtyre reformave duhet të jetë i guximshëm, afatgjatë dhe më strategjik", ka thënë Tahiri.

Ai ka treguar se në fazën e parë fokus i veçantë do të jetë pakoja e ligjeve për reformën e administratës shtetërore, detyrë kjo që del nga Agjenda Evropiane e Reformave (ERA). "Një muaj nga marrja e mandatit, shoh se ekziston vullneti politik dhe institucional që ky proces të përmbyllet. Këtu një qasje profesionale dhe përkushtim të madh e shoh nga Ministria e Administratës Publike, duke përfshirë gjithë mekanizmat institucionale dhe partnerët ndërkombëtarë", ka thënë ai. Tahiri ka vlerësuar se në këtë proces, për dallim nga vendet e rajonit, nuk ka ndarje në mes të pozitës dhe opozitës. Ndër të tjera, Tahiri ka folur edhe për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Ai është shprehur i bindur se nuk do të ketë koncesione të tjera për këtë asociacion. "Mekanizmat e themeluar nuk janë aty për koncesione, por në rend të parë për ta zbatuar në plotësi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, për të siguruar një proces profesional dhe gjithëpërfshirës. Duke u siguruar se draftimi i statutit ka kaluar në një vlerësim final nga Gjykata Kushtetuese dhe se kemi përputhshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës", është shprehur Tahiri.

**"Epoka e re": Z. Tahiri, ju që një kohë jeni emëruar koordinator nacional për reforma shtetërore. Cila do të jetë detyra juaj?**

**Tahiri:** Me propozim të kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për emërimin tim koordinator nacional për reforma shtetërore. Detyra ime

është të koordinoj në nivel vendi procesin e reformave duke shërbyer si interlokutor në mes të institucioneve vendore në të gjitha nivelet dhe koordinimit me aktorët ndërkombëtarë, mekanizmat profesionalë dhe shoqërinë civile. Fushëveprimi i koordinatorit nacional për reforma shtetërore, shtrihet në mbështetje, koordinim, zhvillim dhe zbatim të politikave të përbashkëta në proceset reformuese. Po ashtu, ndihmon koordinimin në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe rritjen e efikasitetit për aktivitetet e ndërmarra në funksion të reformës që dalin nga nismat institucionale, Agjenda Evropiane e Reformave (ERA) dhe promovimin e Synimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG). Fokus në periudhën e parë është mbështetja e procesit të reformave të administratës publike, në veçanti tek pakoja e ligjeve në këtë fushë.

**"Epoka e re": BE-ja dhe ShBA-ja vazhdimisht kanë kërkuar prej institucioneve të Kosovës reforma në administratën publike dhe vazhdimin e reformës zgjedhore. Çfarë qasje do të keni ndaj këtyre dy kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare?**

**Tahiri:** Në fazën e parë fokus i veçantë kam vendosur tek pakoja e ligjeve për reformën e administratës shtetërore. Kjo detyrë del nga Agjenda Evropiane e Reformave (ERA) dhe është shqetësim i ngritur përvitshëm nga Raporti i Progresit për Kosovën. Një muaj nga marrja e mandatit, shoh se ekziston vullneti politik dhe institucional që ky proces të përmbyllet. Këtu një qasje profesionale dhe përkushtim të madh e shoh nga Ministria e Administratës Publike, duke përfshirë gjithë mekanizmat institucionale dhe partnerët ndërkombëtarë. Pra, ekziston një dinamikë e shtuar në këtë proces, përtej kësaj roli i

# guximshme dhe strategjike

Republikës së Kosovës por kjo, para së gjithash, kërkon konsensus dhe vullnet politik nga subjektet politike. Në këtë proces është e domosdoshme një analizë e thellë profesionale duke nxjerrë në pah përparësisë dhe mangësitë e sistemit aktual në mënyrë që në procesin e reformës zgjedhore të kemi qartësi të plotë. Njëkohësisht është tejet e rëndësishme të kemi gjithëpërfshirje dhe analizë të modeleve të sprovuara, gjithnjë duke u përshtatur me kontekstin.

**"Epoka e re":** Ju jeni njohës i mirë i qeverisjes lokale. Edhe në këtë nivel të pushteti jo rrallë është shprehur nevoja e reformave të caktuara. E shihini të nevojshëm ndërmarrjen e ndonjë veprimi në këtë drejtim?

Tahiri: Në këtë drejtim, me nismën e kryeministrit Haradinaj, para një jave kemi lansuar 'Forumit Konsultativ Qeveri-Komuna'. Ky është hapi i parë drejt ndërtimit të një platforme të qëndrueshme dhe forcimit të dialogut, konsultimit,

bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes të dy niveleve të qeverisjes. Në takimin e parë të këtij formati, kryeministri Haradinaj ka prezantuar veprimet dhe dinamikën e punës së qeverisë karshi mbështetjes, promovimit dhe reformës në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të nivelit lokal. Ndërkaq, kryetarët e komunave kanë adresuar sfidat, progresin dhe perspektivën në shërbim të agjendës së përbashkët.

Kjo nismë vlerësohet si një kapitull i ri i komunikimit dhe koordinimit në mes të nivelit qendror dhe lokal jo vetëm si synim i ndërveprimit, por edhe si përgjegjësi ndaj secilit qytetar. Para së gjithash, kjo na siguron ecje të sigurt në rrugën e reformave që duhen ndërmarrë për fuqizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të nivelit lokal. Ky forum do të jetë pjesë e mandatit tim në rolin e koordinatorit nacional për reforma shtetërore, bashkë me dy dikasteret kyç: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrinë e Financave. Në takimet e radhës

të forumit konsultativ Qeveri - Komuna do të adresohen çështjet sektoriale te ministrinë e linjës dhe mekanizmat e tjerë institucionalë.

**"Epoka e re":** Një sfidë me të cilën pritet të ballafaqohet kjo Qeveri është formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Si do të ballafaqohet Qeveria me këtë sfidë?

Tahiri: Qeveria e Republikës së Kosovës do ta trajtojë këtë temë përmes tri ekipeve që do të angazhohen, ku bëjnë pjesë komiteti zbatues, ekipi menaxhues dhe ekipi nacional konsultativ. Për këtë temë është përgatitur platforma e procesit, ku secili mekanizëm do të sigurojë një proces profesional dhe gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve. Është e qartë se procesi do të jetë në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, puna e këtyre ekipeve do të mbështetet edhe nga ekspertë të vendit dhe ndërkombëtar. Ndërkaq drafti apo statuti që do të hartohet do t'i dërgohet për vendim final Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës e cila do ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij.

**"Epoka e re":** Institucionet e Kosovës janë shprehur të vendosura që ky asociacion të mos këtë kompetenca ekzekutive, kurse pala serbe po këmbëngul që asociacioni t'i ketë këto kompetenca. Mund të pritet ndonjë koncesion për këtë asociacion?

Tahiri: Mekanizmat e themeluar nuk janë aty për koncesione, por në rend të parë për ta zbatuar në plotësi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, për të siguruar një proces profesional dhe gjithëpërfshirës. Duke u siguruar se draftimi i statutit ka kaluar në një vlerësim final nga Gjykata Kushtetuese dhe se kemi përputhshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Tashmë është e qartë se bashkësia ndërkombëtare kërkon zbatimin e marrëveshjes për asociacionin bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim që obligon themelimin, garanton se nuk bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

## LV-ja: Pushteti i paraburgosi studentët e SKV-së, që të mos dëgjohej rrëfimi i tyre

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, dhe aktivistja e organizatës Studim, Kritikë, Veprim (SKV), Berita Abazi, në një konferencë për media të dielën kanë folur për masën e arrestit të gjashtë aktivistëve të SKV-së me nga 30 ditë paraburgim. Në këtë konferencë u kërkua lirimi i tyre të menjëhershëm meqë arrestimi si dhe masa e arrestit janë të padrejta. "Ne besojmë se ata janë dënuar dje që të mos dëgjohej rrëfimi i tyre dhe që të mos shihen lëndimet që kanë pësuar. Ata janë të lënduar në shumë të pjesëve të trupit. Me t'u liruara ata do të kishin shumë për të treguar, kësaj ndaj tyre u shqiptua dënimi për 30 ditësh. Pra, gjashtë muaj në total", ka thënë Aliu gjatë kësaj konference.

Ai ka shtuar se paraburgimi është dënimi i cili po zbatohet me lehtësi ndaj aktivistëve e studentëve, sidomos kur ka të bëjë me Lëvizjen Vetëvendosje ose simpatizantët e saj. Këtë paraburgim e konsiderojmë si dënim policor që vazhdon dhunën policore, në parkun e qytetit ku s'kishte kamera.



Kurse aktivistja Berita Abazi ka thënë se aktivistët, pos brutalitetit në parkun e qytetit, pësuan dhunë edhe në ambientet e Policisë së Kosovës. Ajo ka shtuar se ishte dëshmitare e përdorimit të tepruar të forcës policore.

Njëjtë kishte pohuar edhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.

Zyrtarët e LV-së kanë bërë me dije se disa prej studentëve të arrestuar janë duke e humbur

afatin e provimeve. Sipas tyre, ata do të duhej të ishin në fakultetet e tyre dhe nëpër aktivitetet e përditshme, kurse Policia do të duhej të ishte e zënë në ndjekjen e kriminelëve të shumtë që ka Kosova.

parterëve është tejet i madh, por ajo çfarë duhet të sigurohemi ta kemi gjithëpërfshirjen e aktorëve në këtë proces. Është për t'u vlerësuar se ky proces për dallim nga vendet e rajonit nuk ndan pozitë dhe opozitë, por deri në përmblyllje kërkohet qasje e integruar dhe profesionale në mënyrë që të ndërtojmë themele të qëndrueshme që do të na shërbejnë për zhvillim të qëndrueshëm në dekadën e dytë të shtetësisë. Qëndrimi im është të kemi guxim si shoqëri dhe qeveri për t'i parë të metat dhe për t'i sugjeruar një bazë të qëndrueshme të sistemit qeverisës në vend. Për fat keq, ka shumë pabarazi si në hierarki institucionale, funksione publike e shtetërore dhe në paga. Për këtë arsye vizioni i këtyre reformave duhet të jetë i guximshëm, afatgjatë dhe më strategjik. Ndërkaq sa i përket reformës zgjedhore, ky proces është iniciuar nga presidenti i

# Serbia provon sërish të arrestojë shtetas të Kosovës përmes Interpolit

Pamundësia e Kosovës që të bëhet anëtare e Interpolit po shihet si pengesë për spastrimin e listës së personave të kërkuar mbi bazën e fletarrestimeve të Serbisë. Në mesin e atyre që u janë kthyer emrat në këto lista, janë edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj

PRISHTINË, 15 PRILL - Qeveria e Kosovës nuk ka ende një qëndrim zyrtar rreth paralizimeve nga Beogradi për kthimin emrave të shumë qytetarëve të Kosovës në listën e personave të kërkuar nga Interpoli (Policia Ndërkombëtare). Pamundësia e Kosovës që të bëhet anëtare e Interpolit, po shihet si pengesë për spastrimin e listës së personave të kërkuar mbi bazën e fletarrestimeve të Serbisë. Në mesin e atyre që u janë kthyer emrat në këto lista, janë edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Këtë e ka bërë me dije ministri i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Serbisë, Nebojsa Stefanović. Sipas tij, akuzat e organeve të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës janë rikthyer tashmë në sistemin e Interpolit. Në këto lista, ka vlerësuar Stefanović, ndonëse u figurojnë emrat, akuzat ndaj presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ramush Haradinaj nuk do të zbatohen në këtë fazë për shkak të funksioneve që kanë aktualisht Thaçi e Haradinaj. Ministri serb ka thënë se kthimi i akuzave në dosjet e Interpolit

pasoi presionin e Serbisë ndaj këtij institucioni, duke kërkuar që të respektohet e drejta ndërkombëtare. Në Qeverinë e Kosovës kanë thënë se janë duke e përcjellë me vëmendje situatën dhe se janë duke mbledhur informacionet e nevojshme për të dalë pastaj me një qëndrim zyrtar. Zëvendëskryetari i parë i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rexhep Selimi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ky veprim i Serbisë nuk është i papritur. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se këtë e sheh edhe si presion të Serbisë karshi Kosovës për të lëshuar pe në fusha të tjera. "Edhe rikthimin e emrave në listat e Interpolit të shumë pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë e shoh edhe më shumë si një presion që Kosova të lëshojë pe edhe në fushat e tjera. Pra, e dimë se Serbia i do ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në bankat e të akuzuarve, por më shumë se kaq Serbia do që Kosovën ta mbajë në vazhdimësi nën presion, qoftë edhe me këto lista në këtë



rast", ka thënë Selimi. Sipas tij, që këto probleme të mos përsëriten në pafundësi, Kosova sa më parë duhet të bëhet anëtare e Interpolit. "Institucionet e Kosovës duhet të punojnë më shumë që Kosovën ta anëtarësojnë në Interpol, gjë që është mundësia të ndodhë sivjet. Edhe ne po japim kontributin tonë të jashtëzakonshëm edhe nga pozicioni i opozitës dhe, në anën tjetër, do të duhej që me Serbinë ta kishin një qasje tjetër të komunikimit", ka theksuar deputeti Selimi. Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se

Serbia në vazhdimësi ka keqpërdorur pozitën që ka në Interpol për të lëshuar fletarrestime ndërkombëtare ndaj shtetasve të Kosovës. "Sigurisht se rol vendimtar këtu luajnë edhe Bashkimi Evropian, Brukseli, të cilët pothuajse asnjëherë nuk e kanë marrë shumë seriozisht këtë çështje, duke i lënë qytetarët e Kosovës në njëfarë mënyrë në mëshirën e Serbisë, duke i maltretuar në shumë e shumë raste kur të njëjtë janë arrestuar në bazë të këtyre fletarrestimeve, janë mbajtur në paraburgim në shtetet e Bashkimit Evropian me muaj, e ndonjëherë edhe me vite, pastaj të njëjtit më vonë janë liruar", ka thënë Miftaraj.

Në fillim të vitit të kaluar kryeministri i tanishëm i Kosovës, Ramush Haradinaj, ishte arrestuar nga policia franceze, në bazë të një fletarrestimi ndërkombëtar të lëshuar nga Serbia. Haradinaj ishte arrestuar edhe në Slloveni në vitin 2015, arrestim ky i bazuar, po ashtu, në fletarrestimin e Interpolit, lëshuar nga policia e Serbisë në vitin 2006. E, në fund të vitit të kaluar, emri i kryeministrit Ramush Haradinaj dhe emrat e 17 personave ishin larguar nga lista e Interpolit për arrestim. Pritet që gjatë këtij viti Kosova të jetë anëtare e organizatës më të madhe të policisë në botë, Interpol.

## Ministri Tahiri: Do të rritet numri i përmbaruesve privatë



PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Ministri i Drejtësisë (MD), Abeldar Tahiri, ka bërë me dije se do të rritet numri i përmbaruesve privatë në Kosovë. "Sa i përket numrit të përmbaruesve, para disa javësh kanë bërë betimin edhe një numër i ri i tyre, por ky numër do të rritet edhe në të ardhmen mbi bazën e parimit të ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët, duke mbuluar kështu një shtrirje më të gjerë gjeografike", ka thënë Tahiri për "Epokën e re". Ai ka thënë se profesionet e lira ligjore, ku bëjnë pjesë edhe përmbaruesit, në përgjithësi janë një histori suksesi në Kosovë, të cilat kanë mundësuar efikasitet më të madh në qasjen në të drejta dhe kanë mundësuar një efikasitet më të madh në adresimin e çështjeve që lidhen

me aspektin ekonomik. "Megjithatë, si ministër i drejtësisë e konsideroj tejet të nevojshme të ridefinohen edhe një herë vlerat mbi të cilat këto profesione funksionojnë, veçmas në kuptim të adresimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies së tyre. Për të adresuar këtë çështje, këtë vit do të themeloj një njësi të veçantë brenda ministrisë e cila do të ketë mandat të plotë auditimi edhe nga aspekti i llogaridhënies, edhe nga aspekti i përmbajtjes së punës së profesioneve të lira ligjore. Kjo mbikëqyrje e profesioneve ligjore, përkatësisht përmbaruesve privatë, do të mundësojë transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të punës së tyre ndaj qytetarëve dhe subjekteve të tjera", ka deklaruar Tahiri.

# Nis ndërtimi i autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë

Të dielën kanë nisur punimet për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kjo autostradë lidh shqiptarët, ekonominë dhe ndjenjat. Autostrada Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë do të jetë 22.6 kilometra dhe do të ketë katër korsi, ndërsa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti është 30 muaj

**EPOKA E RE****Arbisa SHEFKIU**

**GJILAN, 15 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të dielën në 19-vjetorin e betejës së Zhegotit dhe ka bërë homazhe të rënë në këtë betejë. Përkritazi në nderim të të rënëve nga kjo betejë, të dielën kanë nisur edhe punimet për autostradën Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, në të cilën kryeministri Haradinaj ka mbajtur edhe një fjalë rasti. Para shumë përfaqësuesve të jetës politike të Kosovës, ministra, zëvendësministra, edhe përfaqësues nga Presheva, kryeministri Haradinaj ka thënë se këtë vit ndihemi më mirë se vitet e tjera, kur i kujtojmë të rënë për liri sepse, sipas tij, po bëhemi bashkë, po bashkohet Presheva me

Prishtinën. "Autorruga që lidh Gjilanin-Dheun e Bardhë, i lidh shqiptarët, ekonominë dhe ndjenjat", është shprehur kryeministri, duke shtuar se rreth 87 milionë euro të pjesës së parë të projektit janë të zotuar dhe kohëzgjatja e realizimit është 30 muaj. "Ajo që më bën të krenohem sot është se po i dalim zot çdo pjesë të atdheut dhe Prishtina do të jetë e lidhur me Pejën, Gjakovën, Gjilanin, Preshevën, Shkupin, Tiranën. Pra, gjithë infrastruktura e Kosovës do të jetë e përmbyllur", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se deri më 2023 asnjë qendër e Kosovës nuk do të jetë e palidhur me autorrugë. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se falë gjakut të dëshmorëve ne kemi mundësinë e investimeve dhe modernizimit të infrastruk-



turës sonë rrugore.

Ministri Lekaj ka njoftuar se në fillim të vitit 2019 do të fillojë autostrada tjetër Istog-Pejë - Deçan - Gjakovë. Ndërkaq, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ky integrim i jep Kosovës mundësi, që edhe në korridorin e kombit, Anamorava dhe kjo pjesë, të

integrohen më pak se gjysmë ore, por edhe Kosovës në daljen e korridorit të dhjetë ndërkombëtar, që është Shkup-Selanik.


Autostrada Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë do të jetë 22.6 kilometra dhe do të ketë katër korsi. Kjo autostradë do ta shkurttojë kohën e lëvizjes nga Prishtina në Gjilan, e në këtë

drejtim edhe me Kosovën Lindore dhe anasjelltas.

Për kryeministrin Haradinaj, merita e nisjes së një projekti kaq të rëndësishëm infrastrukturor dhe ekonomik nuk është meritë vetëm e tij apo vetëm e Qeverisë

Haradinaj, por është meritë e gjithë qeverive, e qytetarëve dhe taksapaguesve.

## Belegu thotë se mbi 90 fëmijë janë operuar falas në ShBA



Në një intervistë dhënë për "Radion Evropa e Lirë", Mazllum Belegu ka thënë se në vitin 2009 janë dërguar vetëm dy pacientë, më pas në vitin 2010, 2011 dhe 2012 janë dërguar nga tre pacientë.

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Që nga viti 2009 doktor Mazllum Belegu nëpërmjet organizatës "Gift of Life" ka bërë të mundur që fëmijët me probleme në zemër të operohen falas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Deri më tani më shumë se 90 fëmijë kanë përfituar nga kjo organizatë.

Derisa Ministria e Shëndetësisë paguan shpenzimet e udhëtimit për këta fëmijë, organizata në fjalë mbulon shpenzimet e operacioneve. E gjithë kjo po bëhet në pamundësi për t'u trajtuar këta fëmijë në Kosovë për shkak të mungesës së kardiokirurgjisë për fëmijë.

Në një intervistë dhënë për "Radion Evropa e Lirë", Mazllum Belegu ka thënë se në vitin 2009 janë dërguar vetëm dy pacientë, më pas në vitin 2010, 2011 dhe 2012 janë dërguar nga tre pacien-

të. "Më pas është organizuar misioni prej anës së tyre në vitin 2012, ku kanë ardhur në Kosovë dhe i kanë përzgjedhur fëmijët me probleme në zemër dhe i kanë dërguar 27 fëmijë. Ka qenë një numër imponant. Në vitet e tjera ka pasur ndonjëherë më shumë, ndonjëherë më pak, por mesatarja ka qenë rreth 20. Vitin e kaluar janë operuar 29 fëmijë. Të gjithë këta fëmijë kanë vuajtur nga vrima në zemër, problem me të cilin lindin. Në Kosovë nga Amerika kanë ardhur një kardiolog, drejtori i organizatës "Gift of Life International" me seli në Nju Jork, ka ardhur një infermiere e specializuar për rastet me fëmijë, administratorja e organizatës, e cila i siguron mjetet për trajtimin e këtyre fëmijëve, pasi dikush do të duhej t'i siguronte mjetet, meqë as në spitalet e Amerikës nuk ka asgjë pa pagesë", ka thënë Belegu.

Flet për "Epokën e re", Besian Mustafa

# Industria e drurit dhe e minierave, tërheqëse për investitorët e huaj

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Besian Mustafa, ka bërë me dije se në mesin e sektorëve më atraktivë për investitorët e huaj në Kosovë janë industria e drurit, përpunimi i ushqimit, përpunimi i metalit, përpunimi i tekstilit, turizmi, energjia dhe minierat. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se stabiliteti politik është ndër faktorët më të rëndësishëm për tërheqjen dhe mbajtjen e investimeve të huaja

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINE, 15 PRILL** - Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Besian Mustafa, ka thënë se stabiliteti politik është ndër faktorët më të rëndësishëm për tërheqjen dhe mbajtjen e investimeve të huaja. Ai ka theksuar se përderisa sfidat e fundit politike në Kosovë paraqesin një sfidë, Kosova vlerësohet me stabilitet politik mesatar, veçanërisht kur krahasohet me regjione të tjera në Botë që po përjetojnë turbulencat e mëdha politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka thënë se në mesin e sektorëve më atraktivë për investitorët e huaj në Kosovë janë industria e drurit dhe minierave. "Sektorët më atraktivë për investitorët e huaj janë përpunimi i drurit, përpunimi i ushqimit, përpunimi i metalit, përpunimi i tekstilit, TIK, turizmi, energjia, minierat etj.", është shprehur Mustafa.

Ai ka treguar se në këtë tremujor të këtij viti, KIESA ka përfunduar prodhimin dhe lansimin e 22 videove promovuese, 19 prej tyre nga 30 sekonda që promovojnë kompanitë e suksesshme në Kosovë, qofshin vendore apo të huaja, dhe tri video nga 60 sekonda që promovojnë potencialet investive, turistike dhe eksportuese të Kosovës. Mustafa ka theksuar se KIESA çdo vit në muajin korrik organizon panairin "Gratë në Biznes", me pjesëmarrje ekskluzive për kompanitë që udhëhiqen nga gratë dhe shoqatat e ndryshme të grave ndërmarrëse.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, si e vlerësoni ambientin e të bërit biznes në Kosovë?

**Mustafa:** Mjaft të volitshëm

duke marrë parasysh që në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore për vitin 2018 Kosova është ranguar e 40-ta në botë, veçanërisht e 10-ta për themelimin të biznesit, e 12-ta për qasje në kredi dhe e 34-ta për regjistrim të pronës. Falë këtyre të arriturave Kosova është vlerësuar vendi i katërt më i reformuar në botë dhe reformatori kryesor, pra numër 1, në Evropë. Dimensionet që kërkojnë përmirësim dhe kanë marrë zotim të plotë të QRK-së për mbështetje dhe zhvillim janë marrja e lejeve të ndërtimit dhe qasja në energji elektrike. Për këtë të fundit, QRK së fundmi ka nënshkruar marrëveshje me Contour Global për ndërtimin e termocentralit të ri "Kosova e Re".

**"Epoka e re":** Situata politike në vendin tonë, sa ka paraqitur hendek për investitorët e huaj?

**Mustafa:** Stabiliteti politik është ndër faktorët më të rëndësishëm për tërheqjen dhe mbajtjen e investimeve të huaja. Përderisa sfidat e fundit politike në Kosovë paraqesin një sfidë për ne në këtë drejtim, Kosova vlerësohet me stabilitet politik mesatar, veçanërisht kur krahasohet me regjione të tjera në botë që po përjetojnë turbulencat e mëdha politike.

**"Epoka e re":** Çfarë e ka karakterizuar aktivitetin e KIESA-s në këtë tremujor të këtij viti (TM1)?

**Mustafa:** KIESA në TM1 ka përfunduar prodhimin dhe lansimin e 22 videove promovuese, 19 prej tyre nga 30 sekonda që promovojnë kompanitë e suksesshme në Kosovë, qofshin vendore apo të huaja, dhe tri video nga 60 sekonda që promovojnë potencialet investive, turistike dhe eksportuese të Kosovës. Njëkohësisht, kemi subvencionuar pjesëmarrjen e



ndërmarrjeve të Kosovës në katër panairë ndërkombëtare, kemi ndarë 200 certifikata për të sapodiplomuarit përfitues të programit "Internship Biznesi 2017" dhe kemi organizuar një sesion informues mbi potencialet investive të Kosovës në Malmo të Suedisë. Mbi të gjitha, kemi përpiluar dhe miratuar katër aktet nënligjore që mundësojnë zbatimin e Ligjit për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, ku si rezultat kemi pranuar katër aplikacione për statusin e investitorit strategjik.

**"Epoka e re":** Nga paraqitjet që

keni pasur jashtë vendit, sa kanë shprehur interesim investitorët e huaj për të investuar në Kosovë?

**Mustafa:** Po. Siç e ceka më lart, tanimë kemi katër aplikacione për ta përfituar statusin e investitorit strategjik. Njëkohësisht, kemi vizita të vazhdueshme në Kosovë nga investitorët e huaj potencialë. Së fundmi, është nënshkruar edhe marrëveshja e 'Hotel Marriot' dhe 'Hotel Sheraton' me partner kosovarë për t'i hapur këto hotele në Kosovë, dy brende tejet të suksesshme të përmasave globale.

**"Epoka e re":** Cilët janë sektorët më atraktivë për investitorët e huaj?

**Mustafa:** Përpunimi i drurit, përpunimi i ushqimit, përpunimi i metalit, përpunimi i tekstilit, TIK, turizmi, energjia, minierat etj.

**"Epoka e re":** Sa ka pasur interesim dhe përkrahje nga KIESA për gratë ndërmarrëse?

**Mustafa:** KIESA çdo vit në muajin korrik organizon panairin "Gratë në biznes" me pjesëmarrje ekskluzive për kompanitë që udhëhiqen nga gratë dhe shoqatat e ndryshme të grave ndërmarrëse.



Publikohet analiza me titull "Ndikimi i TC 'Kosova e Re' në tarifat e energjisë elektrike"

# GAP-i: Me TC 'Kosova e Re' rryma shtrenjtohet për 40 për qind

Instituti GAP ka publikuar të dielën një analizë lidhur me ndikimin që do të ketë ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" në raport me çmimin e energjisë elektrike. Blend Hyseni, hulumtues në GAP, ka thënë se me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" çmimet e energjisë elektrike në vend do të rriten për 44 për qind

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Instituti për Studime të Avancuara GAP ka prezantuar një pjesë të analizës me titull "Ndikimi i TC 'Kosova e Re' në tarifat e energjisë elektrike". Analisti i politikave në Institutin GAP, Agron Demi, në një konferencë për medie të dielën ka thënë se propozimi fillestar për ndërtimin e termocentralit "Kosova C" është paraqitur në vitin 2005, ku me Strategjinë e Energjisë (2005-2015), Qeveria e Kosovës kishte planifikuar ndërtimin e një termocentrali me kapacitet prej 2.100 MW dhe me një kosto prej 3.5 miliardë eurosh. "Me ndryshimet në qeverisje në

fund të viti 2008 projekti për termocentralin e ri është ndryshuar si për nga emërtimi i cili filloi të quhej 'Kosova e Re', ashtu edhe për nga kapaciteti energjetik. Fillimisht është propozuar që termocentrali i ri të ketë kapacitet prej 1000 MW, për t'u ndryshuar më vonë në 600 MW. Në mars të vitit 2012 Qeveria e Kosovës ka dërguar tek katër kompanitë e parakualifikuara thirrjen finale për ofertim. Nga katër kompanitë e parakualifikuara, më 23 nëntor të vitit 2015 është shpallur ofertuesi i vetëm 'Contour Global', ka thënë Demi. Ai ka thënë se pavarësisht se thirrja për ofertim ishte dërguar duke u bazuar në Ligjin për prokurimin publik, i cili

parashihet si të suksesshëm një proces tenderues me, së paku, dy oferta, Qeveria nuk e kishte anuluar procesin përkundër marrjes së vetëm një oferte.

Demi ka theksuar se ndërtimi i "Kosovës së Re" është projekt i cili ka ndikim të gjithanshëm në ekonomi, buxhetin e shtetit, shëndet, ambient, zhvendosje të popullsisë, borxhin publik e ndikime të tjera. "Por në këtë raport të shkurtër, Instituti GAP ka analizuar vetëm ndikimin në tarifa të energjisë që do të ketë ndërtimi i termocentralit të ri sipas marrëveshjes së nënshkruar", ka thënë Demi. Ai ka theksuar se në interpelancën e cila do të mbahet sot (e hënë) për termocentralin "Kosova e Re", një ndër rekomandimet që duhet të dalë nga kjo seancë është që t'i kërkohet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) një raport zyrtar për ndikimin e këtij termocentrali në tarifat e energjisë.

Ndërsa Blend Hyseni, hulumtues në Institutin GAP, ka thënë se me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" çmimi i cili paguhet nga konsumatorët do të pasojë një ngit-

je kumulative prej 44 përqindësh në krahasim me çmimin aktual. "Ndërsa çmimi mesatar me shumicë do të rritet në rreth 61.4 euro MWh apo rreth 86 për qind rritje kumulative në krahasim me çmimin aktual", ka deklaruar Hyseni. Ai ka theksuar se modeli i paraqitjes së rritjes së çmimeve të energjisë elektrike për vitet 2018-2026 është tejet konservativ pasi, sipas tij, nuk merren për bazë investimet e tjera që do të bëhen në tregun e energjisë, siç janë dekomisionimi i TC "Kosova A", investimet në TC "Kosova B" prej afër 300 milionë eurosh dhe investimet e tjera në mihje të cilat detyrimisht do të reflektohen në tarifa.

Hyseni ka thënë se nga grupet më të rrezikuara nga rritja e çmimit të energjisë janë familjet të cilat jetojnë nën kufirin e varfërisë. "Nëse bazohemi në të dhënat e prezantuara nga ZRRë-ja rreth shumës së faturuar nga KEDS-i për amvisëritë, çmimin mesatar aktual të energjisë elektrike dhe numrin e konsumatorëve aktivë, del se fatura mujore e energjisë së

këtyre qytetarëve do të jetë mbi 18 për qind (40 euro) e të ardhurave mujore të tërë familjes. Nga investitorët e mëdhenj të huaj në Kosovë, njëherësh konsumatorë industrialë, 'Ferronikeli' dhe 'Sharrçemi' varen në masë të madhe nga përdorimi i energjisë elektrike. Konkretisht, konsumojnë së bashku mbi 12 për qind të energjisë së prodhuar në vend dhe furnizohen drejtpërdrejt nga rrjeti i transmisionit", ka thënë Hyseni. Ai ka thënë se çmimi me të cilin janë furnizuar këto dy ndërmarrje ndër vite nuk ka kaluar vlerën prej 50 euro për MWh, vlerë kjo, sipas tij, më e ulët se ajo për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek konsumatorët dhe bizneset e vogla.

Republika e Kosovës dhe kompania amerikane "Contour Global" kanë nënshkruar më 20 dhjetor të vitit 2017 marrëveshjen për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re". Sipas kësaj marrëveshje, për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" do të investohen 1.3 milion euro dhe do të krijohen mbi 10 mijë vende të reja pune.



## Kryetari i Mitrovicës dhe ai i Kukësit koordinojnë punët për bashkëpunim

**MITROVICË, 15 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim kryetarin e Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu. Gjatë këtij takimi ata vlerësuan të shkëlqyeshëm bashkëpunimin midis Mitrovicës dhe Kukësit. Bahtiri dhe Shehu biseduan edhe për situatën në Mitrovicë dhe për çështje të tjera me interes të përbashkët, si dhe bënë një shëtitje nëpër qytet. Bahtiri dhe Shehu, me vënie e kurorave në shtatorët e heronjve dhe dëshmorëve, do t'i nisin simbolikisht aktivitetet për shënimin e 19-vjetorit të eksodit të shqiptarëve nga forcat serbe. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë edhe përfaqësues të Komunës së Rahovecit. Ky aktivitet përfundon sot (e hënë) në Kukës me një tubim të madh.



## Për më shumë art në hapësirat publike

**PRISHTINË, 15 PRILL (ER)** - Komuna e Prishtinës përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me OJQ Q'ART, me synim që të pasurohen dhe zhvillohen aktivitetet kulturore të ndërlidhura me artin në hapësira publike në kryeqytet. "Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prishtinës dhe OJQ Q'ART, dëshirojnë të lidhin marrëveshje me të cilën të gjitha palët do të punojnë së bashku për realizim të projekteve në dobi të qytetarëve të Prishtinës, sipas synimeve të përcaktuara në kulturë dhe turizëm. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të reja arsimore me fëmijët dhe të rinjtë në Komunën e Prishtinës është një komponentë e rëndësishme për ta rritur dhe theksuar talentin e të rinjve", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



## Përkujtohet dëshmori Ferid Curri

**OBILIQ, 15 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, ekzekutivi dhe qytetarë të shumtë, kanë përkujtuar të

dielën jetën dhe veprën e dëshmorit Ferid Curri nga fshati Mazgit i Ulët, me rastin e përvjetorit të rënies së tij. Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, duke përshëndetur famil-

jarët dhe të pranishmit, përsëriti edhe një herë se amaneti i dëshmorëve është obligim për pushtetin lokal dhe qendror dhe për qytetarët, në mënyrë që gjaku i tyre mos të harrohet kurrë.



## Lushtaku merr iniciativën që ta bëjë me shtëpi të re familjen e Fadil Mulës

**SKENDERAJ, 15 PRILL (ER)** - Ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka vizituar të shtunën familjen pesëanëtarëshe të Fadil Mulës nga fshati Vitak i

kësaj komune. Ai ka treguar se kjo familje deri më tani ka jetuar në kushte të vështira të banimit, në shtëpi të vjetër njëdhomëshe. "Me iniciativën time dhe me

përkrahjen edhe të disa bashkatdhetarëve të vullnetit të mirë, shumë shpejt familja Mula do të bëhet me shtëpi të re", ka thënë Sami Lushtaku.

## Nisma themelon dy nëndegë të reja në Kaçanik

**KAÇANIK, 15 PRILL (ER)** - Nisma Socialdemokrate ka themeluar dy nëndegë të reja në Komunën e Kaçanikut, me ç'rast janë zgjedhur edhe kryetarët e këtyre degëve, Naim Runjeva edhe Lulzim Kuka. Anëtar i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, njëherësh ministër i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka marrë pjesë në këtë aktivitet partiak në Kaçanik. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate po shtrihet çdo ditë e më shumë anekënd Kosovës. "Njerëzit me



vullnet të mirë çdo ditë po u bashkohen radhëve tona në çdo lagje, fshat e qytet. Së

shpejti edhe shumë qytetarë të tjerë do t'i bashkohen Nismës në Kaçanik", ka thënë Hasani.

# Aleatët justifikojnë sulmin ndaj Sirisë



Në takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit të Sigurimit, të kërkuar nga Rusia, përfaqësuesit e ShBA-së, të Britanisë dhe të Francës thanë se sulmi ishte i nevojshëm për ta parandaluar përdorimin e mëtejshëm të armëve luftarake të paligjshme dhe çnjerëzore

**WASHINGTON, 15 PRILL** - Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Franca thonë se sulmi i tyre ajror ndaj objekteve të programit të armëve kimike të Sirisë ishte i bazuar në ligjin ndërkombëtar. Duke folur gjatë takimit të jashtëzakonshëm të Këshillit të Sigurimit, të kërkuar nga Rusia, përfaqësuesit e tre vendeve aleate thanë se sulmi ishte i nevojshëm për ta parandaluar përdorimin e mëtejshëm të armëve luftarake të paligjshme dhe çnjerëzore.

Ambasadori i Rusisë në OKB shprehu revoltimin e Moskës për sulmin e koordinuar ndaj depove të armëve kimike të Sirisë dhe të qendrave të saj kërkimore. "Kërkojmë të ndalojë menjëherë agresionin dhe të hiqet dorë nga përdorimi i forcës së paligjshme në të ardhmen", tha ambasadori rus në OKB, Vassily Nebenzia.

Të shtunën një ekip inspektorësh i Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike mbërriti në Damask për të

hetuar në qytetin Douma. Nebenzia kritikoi tri fuqitë perëndimore për kryerjen e sulmeve ajrore përpara se ekipi i inspektorëve ta përmbushte detyrën dhe t'i nxirrte konkluzionet. "Kështu i doni të zhvillohen tashmë marrëdhëniet ndërkombëtare? Ky është hulumtim në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe jo hulumtim në vogël, pasi bëhet fjalë për fuqi kryesore bërthamore", deklaroi ambasadori rus.

Tri fuqitë perëndimore iu përmbajtën pikëpamjes se sulmet ishin të justifikuar, legjitime dhe proporcionale. "Goditëm me sukses në zemër të sistemit të armëve kimike të Sirisë dhe jemi të sigurt se kemi dëmtuar programin sirian të armëve kimike. Jemi të gatshëm ta ruajmë këtë presion, nëse regjimi sirian do të testojë me pamendësi vullnetin tonë", tha ambasadorja e ShBA-së në OKB, Nikki Haley.

Rusia u shpreh gjithashtu se sulmet

bien në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e OKB-së. Ambasadori i Francës nuk ra dakord. "Do t'ju kujtoja se ajo kartë nuk u hartua për të mbrojtur kriminelë", tha ambasadori francez në OKB, Francois Delattre.

Ambasadorja e Britanisë tha se veprimi ushtarak ishte i kufizuar dhe shmangu viktimit në radhët e civilëve. "Mbretëria e Bashkuar mendon se ishte e drejtë dhe e ligjshme ndërmarraja e veprimit ushtarak, së bashku me aleatët tanë më të afërt, për t'i lehtësuar vuajtjet e mëtejshme njerëzore duke degraduar aftësitë e regjimit sirian për armë kimike dhe duke parandaluar përdorimin e tyre", tha ambasadorja e Britanisë në OKB, Karen Pierce.

Rusia dështoi në përpjekjen për të miratuar një rezolutë që do ta dënonte sulmin, duke marrë vetëm tri vota për, nga 15 vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit.

## LAJME SHKURT

### Putini: Sulmet e tjera në Siri dërgojnë drejt kaosit

**MOSKË, 15 PRILL** - Presidenti rus, Vladimir Putin, ka deklaruar se çdo sulm tjetër nga fuqitë perëndimore kundër Sirisë do të "dërgojë pashmangshëm drejt një kaosi në marrëdhëniet ndërkombëtare".



Putini ka bërë këtë paralajmërim më 15 prill gjatë një bisede telefonike me presidentin iranian, Hasan Rohani, bazuar në një njoftim të Kremllit. Është raportuar se të dy presidentët janë pajtuar që sulmet e 14 prillit të ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, përbëjnë shkelje të ligjit ndërkombëtar dhe "kanë dëmtuar mundësitë për gjetjen e një zgjedhje në Siri".

Sulmet ajrore kanë ardhur në përgjigje të sulmit të dyshuar me armë kimike në Siri, në të cilin kanë vdekur dhjetëra persona javën e kaluar. Ambasadorja amerikane në Kombet e Bashkuara, Nikki Haley, ka thënë në Këshillin e Sigurimit se sulmet kanë qenë të "justifikuara, legjitime dhe proporcionale". "Kam folur me presidentin amerikan, Donald Trump. Ai ka thënë se 'nëse regjimi sirian do të përdorë sërish gaz helmues, Shtetet e Bashkuara janë të gatshme për sulme', ka thënë Haley.

### Johnson: Britania do t'i shqyrtojë mundësitë nëse Assadi kryen sërish sulm kimik

**LONDËR, 15 PRILL** - Britania do t'i shqyrtojë mundësitë me aleatët nëse presidenti sirian, Bashar al-Assad, përdor sërish armë kimike kundër popullatës në Siri, mirëpo deri më tash nuk është planifikuar asgjë, ka thënë ministri i



Jashtëm britanik, Boris Johnson. Johnson ka mbështetur vendimin e kryeministres britanike, Theresa May, për t'iu bashkuar sulmeve të Shteteve të Bashkuara dhe Francës, për t'i qëlluar bazat e armëve kimike në Siri, duke thënë se ai vendim ka qenë hapi i duhur për ta dënuar përdorimin e armëve kimike. "Ende nuk ka ndonjë propozim në tavolinë për sulmet e ardhshme sepse deri më tash regjimi i Assadit nuk ka qenë aq i pamend për të nisur sulme të reja kimike", ka thënë ai për BBC-në. Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Britania më 14 prill kanë nisur sulme të përbashkëta ajrore, pas sulmit të supozuar me armë kimike që ka ndodhur javën e kaluar në qytetin sirian Duma dhe ka lënë të vdekur dhjetëra persona.

## Protestat në Francë që po sfidojnë Macronin

**PARIS, 15 PRILL** - Autoritetet franceze kanë thënë se 63 persona janë arrestuar dhe nëntë zyrtarë policorë janë plagosur në protestat që janë mbajtur në dy qytete të Francës, pas rritjes së pakënaqësive për ndryshimet ligjore nga laboristët e presidentit Emmanuel Macron, transmeton AP.

Ministri i Brendshëm, Gerard Collomb, ka dënuar dhunën dhe dëmin në dyqane dhe ndërtesa publike në protestat e së shtunës. Ai ka bërë thirrje për qetësi në protestën e radhës që është planifikuar të mbahet në perëndim të Francës.

Punëtorët e trenave janë duke marshuar dhe duke mbajtur

grevë pas njoftimit për reforma. Macroni ka mbajtur të dielën në mbrëmje një fjalim televiziv për të dhënë shpjegime për reformat e tij në ekonominë franceze. Ai ka thënë se do ta bëjë shtetin më garues në aspektin global, ndërkohë që punëtorët frikësohen për humbjen e vendeve të punës.



Në Shkodër, te Bedri Islami, me Ali Ahmetin dhe Ramiz Lladrovcin

# TE NËNË DRITA E



**Ismet SYLEJMANI**

Shoku, bashkëveprimtari, bashkëluftetari e miku ynë i madh Bedri Zenel Islami dhe Nëna e Tij Drita, por edhe familja e tij në Shkodër, ishin mikëpritese të një vizite të madhe dhe historike!

Data 8 prill e vitit 2018, do të jetë e shënuar dhe do të mbetet ngjarje e madhe, sepse u bë një vizitë historike, por pa jehonë paraprake në Shkodër! Vizita Nënë Dritës dhe djalit të saj të lavdishëm, ish-Kryetarit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, patriotit e veprimtarit të madh e të devotshëm, të nderuarit Bedri Islami, ishte dhe mbetet padyshim ngjarje e shenuar jo vetëm për të gjithë neve, por edhe më gjerë!

Këta njerëz të mrekullueshëm e kjo familje e madhe shkodrane, që nga gjui i madh i saj kishte nxjerrë emra të mëdhenj e të dëgjuar, që popullit dhe Atdheut i kishin dhënë shkelqim edhe më të madh me kontributet e tyre të medha kombëtare e historike, për të cilat kombi ynë, i nderon me pietet përgjithmonë, janë mburrja jonë, sepse janë pjesë aktive e çlirimit të Kosovës dhe viseve të saja nga Serbia pushtuese!

Mirëseardhje na uruan Nënë Drita e Bedriut, bija e fisit me nam të Gjylbegajve të Shkodrës e bashkëshortja e Zenel Islamit, dhe shoku e miku ynë i madh e i nderuar Bedri Zenel Islami, djali i personazheve të famshme të Migjenit, Lulit të Vocër dhe Zeneli!

## Vizitë e paharruar në Shkodër!

Ditë e madhe për ilegalët e luftës për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nën ish-jugosllavi!

## Momente të papërsëritshme!

Personalitetet të cilët në periudha të ndryshme të historisë së kombit tonë kanë bartur mbi supë pesha të mëdha dhe misione historike, apo edhe kanë qenë personazhe përpara të cilave përulet me



respekt flamuri i fitoreve të mëdha në luftë kundër pushtuesvenga të gjitha anet, ishin bashkë në Shkodër!

U ulën shtuar e përballë në shtëpinë 100 vjeçare të fisit të Gjylbegajve, në të cilën jeton e fortë Nëna e madhe Drita!

Kjo grua fisnike shkodrane, që për fat të jetës së saj kishte pasur ta kishte për

bashkëshort nxënësin por edhe personazhin e famshëm të Migjenit, Lulin e Vicër e Zenelin, na e lindi dhe rriti Bedriun e madh e të përkushtuar maksimalisht në çështjen kombëtare, i cili në momentet më vendimtare të luftës ushtarako-çlirimtare në Kosovë, drejtoi me profesionalizem e atdhedashuri Lëvizjen Popullore të Kosovës!

## Rrugëtim historik!

## Në Shkodër me Ali Ahmetin e Ramiz Lladrovcin!

Në Shkodër për herë të parë në jetën e Tij, ishte Udhëheqësi i Popullit Shqiptar Ali Ahmeti, i shoqëruar nga vëllau i Heroit

të Kombit Gjeneral Fehmi Lladrovci, ish i ngarkuari në ambasadën e Kosovës në Shqipëri e Kryetar i Drenasit, ambasador Ramiz Lladrovci dhe unë (Ismet Sylejmani)!

## Ali Ahmeti për herë të parë në jetën e Tij, në Shkodër

Si ka mundësi që Udhëheqësi i Popullit Shqiptar shoku e miku im i madh Ali Ahmeti, për herë të parë të shkelte në këmbë Shkodrën e famshme, qytetin e heroizmave të mëdha e të panumërta, qytetin e personaliteteve legjendare, qytetin ku kanë jetuar Pashko Vasa, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Oso Kuka, Luli i Vocër, por edhe Bedri Pejani nga Kosova dhe ku kanë defiluar patriot e atdhetare të mëdhenj e të panumërt!

## Shumë e thjeshtë!

Kurrë në jetën e Tij, Udhëheqësi i Popullit Shqiptar Ali Ahmeti, nuk kishte udhëtuar në Shqipëri vetëm për vizitë e për pushime luksi, por përkundrazi, gjithmonë në Shqipëri, kishte udhëtuar me mision dhe për interesa e



# BEDRI ISLAMIT



**U nisëm për të vizituar  
Kalanë e Shkodrës!**

**Momente rrënqethëse!**

Ecja nëpër kalldremin shekullor dhe hyrja në portat e mëdha të cilat nuk arriti ti hapte kurrë me sulme e luftë por edhe beteja të panumerta, ushtria më e madhe e kohës e perandorisë osmane, të bënte të ishte i madh kujtimi i të kaluarës së bujshme i të parëve tanë, por edhe i kësaj kështjelle të pamposhtur shqiptare!

Në bedenet e kalasë heroike, duke shikuar rreth e rrotull hapsirën dhe shtrirjen e gjeografisë së Atdheut që ishte fantastike, por edhe kur kujtohesha se kisha në dy anët e krahëve burra të medhenj te kombit si Ali Ahmetin, Bedri Islamit dhe Ramiz Lladrovcin!

Te unë edhe më shumë i shtohet madhështia vizitës së kësaj kalaje fatose të qëndrës shekullore kundër të gjithë armiqtëve të Shqipërisë! Në Kalanë e Shkodrës, aty ku ishte bërë lufta finale në mes të ushtrisë së Arbërit dhe ushtrisë pushtuese turke, isha së bashku me Ali Ahmetin edhe unë për herë të parë në jetën time, çfarë koinçidence! Kisha lexuar kronika e libra të autorëve të ndryshëm për luftën dhe rrethimin e Shkodrës, por të pashlyera në kujtesën time kanë mbetur librat e Gjergj Merulas dhe

çështje të mëdha ilegale, politiko-kombëtare, në shërbim të drejtimit e komandimit të luftës së armatosur çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës dhe viseve të saja nën ish-Jugosllavi! Gjithmonë ishte afruar deri në gjysmë të rrugës për Shkoder, dhe kishte kthyer djathtas nga edhe ishte rruga e Tij e madhe për në Tropojë, nga ku është derdhur si vullkan zingjiri i pafund i luftëtarëve të armatosur çlirimtar shqiptar, nën amblemën e shenjtë të UÇK-së, në drejtim të Kosovës dhe viseve të saja atëherë të pushtuara nga Serbia!

**Në Shkoder, vizita ishte  
me plot emocione!**

Pritje e ngrohtë vëllazërore, e përzemert dhe e thjeshte, pritje puro shqiptare!

Nënë Drita qëndronte në krye të dhomës të shtëpisë së madhe të Gjylbegajve, të ndërtuar nga të parët e fisit të saj, ku u pritëm me aq ngrohtësi e dashuri të panjohur më parë!

Pas qëndrimit me shumë se një ore e bisedave me Nënë Dritën, Bedriun dhe të tjerët, u larguam nga kjo familje lavdimadhe shkodrane, duke i uruar Nënë Dritë të Bedriut jetë të gjatë e të lumtur!



Marin Barletit, që bëjnë fjalë për rrethimet e viteve 1474 dhe 1478!

Heroizma të mëdha ka treguar populli shqiptar në historinë e qëndrës shumë shekullore! Pjesë e kësaj lavdie të madhe ishte edhe Kalaja e Shkodrës, e cila është dëshmitarja e drejtëpërdrejtë e të bëmave të mëdha të heroizmave të pashembullt të shqiptarëve kundër pushtuesve të ndryshëm që mësyenin tokën shqiptare!

**Në kalanë e Shkodrës  
ashtu sikur në Vlorë, u  
ngrit flamuri i Nëntorit të  
lavdishëm!**

Flamurin e Pavarësisë së Shqipërisë edhe në Shkoder në kalanë legjendare e kishte ngritur Muharrem Gjylbegu, kryetar i bashkisë së qytetit, gjyshi i Nënë Dritës, daja i Bedri Islamit! Po largoheshim nga vizita në Kalanë e Shkodrës me pershtypje të mëdha e kujtime të cilat nuk do të na shlyhen deri në

vdekje!

Historia e popullit shqiptar, në të ardhmen do të flet edhe për këtë vizitë, e cila ndonëse ishte zhvilluar pa ceremoni zyrtare dhe e pa mbuluar nga shtypi dhe radiot e tv-të, ishte vizitë historike dhe me karakter të veçantë: vizite Nënë Dritës të Bedri Islamit!

Vizitës sonë kuptim edhe më të madh i ka dhënë, me aparatit dhe fotot e Tij, dhëndrri i Bedri Islamit, djali i këndshëm tepelenas Gazmir Lame, të cilin e falenderojmë shumë!



**E rrallë**

# Kosh i përkryer me ndihmën e elefantit

Një akrobat ka treguar aftësitë e tij të pabesueshme me një nga elefantët e tij të trajnuar. Rene Casselly Jr, i cili punon në një cik hungarez, ka realizuar një kosh të përkryer me ndihmën e elefantit. 21-vjeçari është hedhur në ajër nga elefanti duke realizuar gjuajtjen të përkryer.



**FOTO E DITES**



Intervenimi i ShBA-së me raketa në Damask kundër armëve kimike në Siri të Bashar al-Assadit. /AP/

**E rrallë**

# Avioni me pasagjerë bën ulje emergjente për një stilolaps

Një fluturim ajror i një kompanie kineze bëri një ulje emergjente pasi një pasagjer kërcënoi një mjek me fluturim me një stilograf, ka njoftuar autoriteti i aviacionit civil të Kinës. Avioni ishte nisur për në Pekin të dielën, ndërsa bëri



ulje të paplanifikuar në qytetin qendror kinez të Zhengzhou.

**BARSOLETA E DITËS**



**Roja dhe hajni:**  
**Roja:** Ku po i çon drutë, o zotëri?  
**Hajni:** Po ua çoj lopëve.  
**Roja:** Po lopët nuk i hanë!  
**Hajni:** Mos i hangshin, i djegin.




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

## “BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
 Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

## “PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
 Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

## “PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
 Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

## “RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenaerts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
 Regjia: Francis Lawrence



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**  
 Çështjet e zemrës sot do të jenë

kryefjala e ditës. Ndjenjat dhe emocionet janë të gjalla dhe do t'ju shoqërojnë në çdo moment.



**DEMI**  
 Sot nuk jeni ngritur me humor të mirë dhe

do të afektoni edhe personat që janë pranë jush. Sjellja arrogante do t'ju kthehet kundër.



**BINJAKËT**  
 Ambienti që ju rrethon është i

mbushur me stimuj elektrizues për projekte të reja dhe inovative. Çdo gjë po shkon në vendin e duhur.



**GAFORRJA**  
 Jeni pak të shqetësuar me atë që po ndodh

në ambientin tuaj të punës. Ndryshime drastike dhe të menjëhershme kanë shtuar pasigurinë.



**LUANI**  
 Sot në ditën tuaj do të mbizotërojë

buzëqeshja. Çdo situatë dhe çdo person i afërt ju bën të lumtur dhe ju bën të buzëqeshni.



**VIJGJËRËSHA**  
 Ndihehi disi tradicionale sot

dhe do të bëni gjithçka sipas porosive të më të mëdhenjve. Ju pëlqen kjo gjë, megjithëse e praktikoni rrallë.



**PESHORJA**  
 Jeta sociale do të ketë shumë larmi

sot dhe ju do të jeni në qendër të saj. Për çdo situatë të ndryshme që po jetoni keni një shpjegim tuajin.



**AKREPI**  
 Ndihehi të zhgënjyer nga gjithçka sot dhe

asgjë nuk po ju hyn në sy. Do kërkon mbrojtje tek një mik i mirë që nuk ju ka lënë asnjëherë në baltë.



**SHIGJETARI**  
 Sot duhet të hidhni pas

krahëve një humbje tuajën apo një dështim në dashuri. Koha shëron çdo gjë, mjaft ta lejoni të veprojë.



**BRICJAPI**  
 Ju rrethon një aureolë qetësie dhe

harmonie sot që po ju bën më tërheqës në sytë e të tjerëve. Jepini mundësi dikujt të shprehet.



**UJORI**  
 Dita sot do të jetë mjaft produktive

sa i përket karrierës. Në mbrëmje do të kënaqeni në një darkë mes miqsh.



**PESHQIT**  
 Sot do të gjendeni të përfshirë

në një debat kulturor që do t'ju nervozojë disi. Shpenzime të paparashikuara sa i përket familjes.

Një vepër studimore që e nderon shkencën e albanologjisë - (Vebi Bexheti, "Magjia e fjalës poetike", Tetovë, 2018)

## Tema të ndryshme që dëshmojnë pjekurinë e poezisë shqipe



Prof. dr. Emin KABASHI

Në tërësinë e veprës së tij studimore, "Magjia e fjalës poetike", studiuesi Vebi Bexheti, është marrë edhe me një varg çështjesh, karakteristike për poezinë e krijuesve të ndryshëm. Një temë e veçantë është ajo, ku në poezi të krijuesve të ndryshëm, është shpaluar tërësia e gjeografisë së atdheut, të atij atdheut që e kishte shpallur Ismail Qemali në Vlorë, më 28 nëntor të vitit 1912. Në studimin "Gjeografia shqiptare në disa poezi shqipe, pas pavarësisë së Shqipërisë", studiuesi fillimisht është marrë me poezinë e Gjergj Fishtës, i cili, Konferencës së Ambasadorëve në Londër ia kushton një këngë të veprës së tij madhore "Lahuta e Malcis". Së pari, duke pasur iluzione se më në fund Evropa e kishte bërë të vetin parimin e drejtësisë dhe nuk do të përgjysmonte tokat shqiptare dhe popullin shqiptar. Së dyti, kur realiteti historik vjen si gjëmë që del nga deti, siç do të thuhet me gjuhën e eposit tonë, atëherë poeti Gjergj Fishta shkruan poezinë "28 Nanduer 1913". Poezia është shkruar në njëvjektorin e shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar. Poeti, tashti i drejtohet zanës, jo për të kënduar, por për të vajtuar për fatin tragjik të atdheut të tij, deri në atë shkallë, sa as Flamuri kombëtar më nuk kishte asnjë vlerë, ngase si mund të kishte kuptimin e simbolit të bashkimit kombëtar, kur kishte mbetur një gjysmë Shqipërie. Fishta e i madh, zbrazet më mllëf: "Jo, jo Shqyptarë! Por banje flamurin duqe / E zhytnje n'Dri t'mos ta zhvillojë kurrë era / Flamuri kombëtar nuk ka shka ban dër ne / Po kje se dashtuni nuk kem

p'r Atdhe!" (Po aty, 143). Më mirë, si një poet, që fati i atdheut ishte më i rëndësishëm se çdo gjë në jetë, se tragjedia e atdheut ishte aq e madhe, sa as thadrimi i vargut poetik nuk kishte më kuptim, atëherë vjen poezia-kushtrim, që të rralla i ka shoqet në tërë poezinë e periudhës së pas pavarësisë së Shqipërisë. Poeti kombëtar i thërret shqiptarët: "Ktu, ktu shqyptarë!...A ndiet!...ku u kam... Ku jeni./ Mo' leni burra!...M'armë!...Mbaroi Kosova!.../ Ianina humb!e ndoshta Tepeleni.../ Shkoi Manastiri! Dibra dhe Gjako!.../ Vendet ma t'mira ne na i mori shkja, / E shk'asht ma zi, në vlla me vlla na dau! / Ah: m'kamb, bre burra! M'kamb! Shka / jeni m'heshun/ ndër furkat t'gravet..." (143), duke ia dhënë poezisë së tij, rolin dhe detyrën që nuk e kishte arti poetik, pra duke ia ngarkuar barrën e flijimit për lirinë e atdheut, që në një mënyrë, a në një tjetër, bëhet kult poetik i poetit tonë, siç edhe i pjesë më të madhe të krijuesve tanë të Rilindjes kombëtare.

Poezi të këtitilla, me temën dhe motivin për pavarësinë e Shqipërisë, por edhe për copëtimin e gjeografisë kombëtare, pas kësaj pavarësie, kanë shkruar edhe poetët e tjerë. Ndër ta edhe Sejfulla Malëshova, që po ashtu, është karakteristik, edhe për faktin se ai, njësoj si rilindësi i madh Naim Frashëri, si poeti i madh, Gjergj Fishta, numëron viset shqiptare që ia kishin hequr gjeografisë së atdheut, duke i ftuar djalërinë shqiptare që të ngrihej në luftë për liri, se pa gjakun tuaj, nuk çlirohet dhe nuk bashkohet vendi.

Një krijues i veçantë, në punë të ligjëritimit poetik, edhe specifik, me mënyrën e shtjellimit të lashtësisë kombëtare dhe të së drejtës së luftës për çlirim dhe liri, sidomos në poemën e tij madhore, Poem kosovar, është Mitrush Kuteli. Një vepër poetike, e rrallë për frymëzimin e saj atdhetar, fillon nga shekujt e Ilirisë e vjen në ditët e copëtim-

it të gjeografisë së atdheut, duke shpërfaqur tragjedinë e Kosovës, si pjesë të tragjedisë së atdheut, kurse në nëntekstin poetik, ka qëmtuar edhe prapaskanat e zhbërjes dhe asimilimit të pjesëve të popullit shqiptar, herë duke i shpërngulur me dhunë, herë duke i përçarë vëlla me vëlla. Por, për çudi të lexuesit shqiptar, dje dhe sot, kjo vepër, pas botimit të saj në Tiranë, në vitin 1924, botohet vetëm pas 67 vjetësh në Prishtinë, në vitin 1991.

Qoftë edhe vetëm ky fakt, krejt teknik, flet shumë, aq shumë sa bëhet klithmë për gjendjen tonë të dashurisë ndaj lirisë së atdheut dhe bashkimit kombëtar. Përkundër faktit se sakrifica për lirinë dhe atdheun nuk ka munguar kurrë, nuk mund të merret me mend, se ç'nevojë kishte poezia të bënte thirrje të këtitilla për ta mbajtur gjallë idealin e lirisë së vendit, derisa historia i kishte futur veshët nëlesh, e pjesë të atdheut copëtoheshin dhe zbrazeshin çdo ditë e më shumë. Por, poetin e mban gjallë ideali i dashurisë ndaj atdheut, andaj hero i tij lirik, më në fund, ngre zërin, si në vargjet: "Jam/ tani/ unë jam gati/ të vdes që sot/ s'rroj për mot/ mbytem me gjak/ po jo me lot/ Për këtë dhe q'e kam si fe/ e përmbi fe/ E kam Vatan! / E kam Atdhe!". (146). Pavarësisë së atdheut, Shqipërisë, por edhe copëtimin të saj i kanë kushtuar poezi, edhe poetët e tjerë shqiptarë, disa nga të cilët, shumë të veçantë me vlerat e përgjithshme të artit të tyre poetik. Poezi me këtë motiv ka shkruar edhe Lasgush Poradeci, por ka shkruar edhe Ernest Koliqi, e ndonjë tjetër.

Në veprën e tij studimore, "Magjia e fjalës poetike", studiuesi Vebi Bexheti, një studim të veçantë ia ka kushtuar artit të poezisë së Esat Mekulit, duke e cilësuar edhe si një shkollë me vete, qoftë poezinë e tij, qoftë veprimtarinë e tij kulturor në fazat e para të zhvillimit të letërsisë shqipe në këtë pjesën e pushtuar të atdheut.

Një temë interesante, qoftë për mënyrën e konceptimit, qoftë

mënyrën e shqyrtimit, të cilën studiuesi e ka vështruar, e ka analizuar dh e ka shqyrtuar nga një kënd i veçantë, është studimi "Personazhi i gruas bashkëshorte në poezinë e Dritëro Agollit". Mund të thuhet se e veçanta e analizës së këtij motivi në poezinë e Agollit, lidhet në radhë të parë me krijuesin, pastaj me gruan bashkëshorte, sepse ajo bëhet mbështetëse e përhershme e poetit. Janë disa poezi të Dritëro Agollit, që studiuesi ka marrë në shqyrtim, duke specifikuar te secila rolin e gruas në jetën dhe krijimtarinë e poetit. Të tilla janë poezitë, "Pasuria", "Qetësia e bukur". Poeti jo vetëm i këndon gruas bashkëshorte, por ia numëron barrën jetësore që asaj i ka rënë hise, duke pasur një burrë krijues: "Të kam lënë fëmijë e shqetësime mbi shpinë, / Të kam lënë pazarin, radhën e netët fillikat, / të kam lënë mbi shpatulla gjithë shtëpinë". (166). Ka edhe poezi të tjera që i ka marrë në shqyrtim studiuesi, sa duket, edhe për të shpaluar atë thjeshtësinë e mrekulueshme të bërjes poezi, që ishte cilësia e parë e poetit të madh, Dritëro Agolli. Të tilla janë poezitë, "Vjersha e varër", por ndoshta më e veçantë është poezia "Do të më kujtosh" ku poeti e di se ç'bohllëk lë vdekja, por e di edhe jetën e përtëjme të artit të fjalës poetike.

Studimi i Vebi Bexheti do të ishte i mangët, pas shqyrtimit e një aspekti të veçantë të krijimtarisë poetike të Ismail Kadaresë. Andaj, titulli i studimit "Kadareja i dashuruar", jo vetëm zgjon kureshtjen e lexuesit, ngase pret me padurim, për të hetuar qasjen e studiuesit, si dhe ku e ka mbështetur përkufizimin e këtitillë që në titull të studimit të tij.

Studimi merret me një dorë poezish të Kadaresë, të shkruar gjatë qëndrimit të tij për studime në Moskë, të cilat janë botuar në vëllimin e shtatë të kompletit të tij, në vitin 2008. Për lexuesin shqiptar, tashti më janë të njohura poezitë e poetit,

kurse ndër më të veçantat janë poezia "Mall", poezia "Edhe kur kujtesa", poezia tjetër, "Do të vijë koha", që njësoj si këto që u zunë në gojë trajton motivin e ndarjes së të dashuruarve, njëri nga ky Ballkani i trazuar, tjetra nga veriu i Evropës, por që ishte komuniste. Por, përkundër faktit se një pjesë e poezive të Kadaresë, që ka trajtuar studiuesi Vebi Bexheti, ruajnë brenda strukturës së tyre, motivin e ndarjes, aty nuk ka dhembje, as nuk ka lot qaramanësh, me çka ishte mbushur, jo vetëm poezia shqipe e kohës, por edhe poezia e popujve të tjerë që jetonin nën tutelën e ideologjisë komuniste.

Poeti Kadare, thotë studiuesi, përkundër ndarjes, e ndjenë lumturinë e çastit, duke e lënë hapur dilemën e madhe poetike: "këto flokë biondë / Mbi qafën time derdhur. / Cili i lumtur / Të tillë e ka për kërdhelur". (178). Studiuesi Vebi Bexheti, mendon se poema e tij Lora, e cila një kohë të gjatë nuk ishte botuar, është krijimi më specifik me motivin e dashurisë në poezinë e Kadaresë. Ideologjia, vjen dhe hyn në mes të të dashuruarve. Vjen urdhri që të rinjtë shqiptarë të largohen nga Moska, ku studionin, demos edhe ku dashuronin. Atëherë, poetit Kadare, nuk i kishte mbetur tjetër, përveç ta përjetësoi, afshin e dashurisë së këputur, dhe dhembjen e pafund, deri te mjegullimi i njeriut: "Zor se në jetë do takohemi. / Adresat humbën, / S'ka letra. / Ti mjegullat, / Unë retë / Do t'i dërgojmë / njëri tjetrit / Gjersa edhe vetë / Të mjegullohemi". (179). Shqyrtimi në tërësinë e tij, ka prekur të gjitha nivelet e realizimit artistik të kësaj poeme të Ismail Kadaresë, duke qëmtuar herë një figurë mendimi, si thënie poetike e veçantë, herë tjetër një metaforë, për të cilat Kadare është mjeshtër, pastaj një alegori, që e bën poezinë të përgjithshme, janë veçorit që e karakterizojnë shqyrtimin e studiuesit të Vebi Bexhetit në këtë studim kushtuar poezisë së dashurisë të Ismail Kadaresë.

(Vijon)

## Më 19 prill bëhet hapja e ekspozitës së piktorit Demush Avdimetaj

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Më 19 prill në orën 19:00, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës bëhet hapja e ekspozitës "Simbiozë e Artit Klasik dhe Modern" të piktorit Demush Avdimetaj. Kjo ekspozitë përmban tridhjetë (30) punime, vepra pamore - vizatime dhe piktura të real-

izuara në teknikat akrilik në pëlhurë, akrilik në letër, teknikë e kombinuar, etj. të cilat paraqesin elemente reale dhe të imagjinuar poetike, me kontura vizatimore grafike, piktoreske e skulpturore.

Piktori Avdimetaj është një ilustrator i shquar dhe një piktor me

identitet të formësuar prej artisti.

Demush Avdimetaj dëshmon prirjen e tij për dy lëmitë artit pamor, vizatimin që është bazë dhe pikturën.

Peizazhet lirike merren nga natyra, por transponohen varësisht nga emocionet,

disponimet dhe përjetimet estetike, duke krijuar imazhe vizuale mbresëlënëse, asociative dhe refleksive.

Avdimetaj ka realizuar mbi 20 ekspozita personale, ndërkaq kjo është ekspozita e tretë me radhë në Galerinë e Ministrisë së Kulturës.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	WEST HAM - STOKE	2	BRESTOIS - LORIENT	1	JONG AJAX - NEC	1
-------------------	------------------	---	--------------------	---	-----------------	---

# Prishtina s'i ndahet Dritës; '89-shi, bindës ndaj Vëllaznimit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Të dielën janë zhvilluar edhe dy ndeshjet e fundit për xhiron e 27 në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Drita e mposhti Vllazninë e Pozharanit, kurse Trepça '89 në "Riza Lushta" doli bindëse ndaj Vëllaznimit të Gjakovës. Prishtina në këtë xhiro ka fituar ndaj Besës dhe vazhdon të jetë konkurrentja kryesore e Dritës në garë për titull. Fitore ka shënuar edhe Llapi ndaj Lirisë, kurse Drenica e mposhti Flamurtarin.

## Trepça '89 - Vëllaznimi 3-0

Fitore bindëse të dielën ka shënuar Trepça '89 ndaj Vëllaznimit me rezultat 3-0. Pak minuta para fundit të pjesës së parë, sulmuesi më i mirë i kampionatit të kaluar, Otto John, i solli vendësit në epërsi 1-0. Mbrojtësi Lapidar Lladrovci (70) e shtoi diferencën e golave, kurse John (78) e vulosi rezultatin përfundimtar 3-0. '89-shi me këto tri pikë të reja është dhjetë pikë pas kryesueses, Dritës, kurse Vëllaznimi i nënti, me 35 pikë të grumbulluara.

## Drita - Vllaznia (P) 2-0

Drita e Gjilanit po e vazhdon sigurt rrugëtimin drejt titullit të kampiones, pasi shënoi fitore edhe ndaj skuadrës së fundit në renditjen tabelore, Vllaznisë së Pozharanit (2-0). Golin e parë në ndeshje e shënoi Fidan Gërbeshi (18) nga penalltia, kurse për mysafirët u vështirësuan edhe më shumë punët njëmbëdhjetë minuta më vonë, kur u përfshijua nga loja Elbasan Thaqi. Pesë minuta pa përfunduar ndeshja, Drilon Musaj e vulosi rezultatin final 2-0. Drita vazhdon të jetë tri pikë para Prishtinës, kurse Vllaznia është e fundit me 14 pikë.

## Prishtina - Besa 1-0

Prishtina e vazhdon garën për titull, pasi të shtunën e mposhti Besën e Pejës me rezultat 1-0. Golin e fitores për kryeqytetasit në këtë ndeshje e shënoi Ahmet Januzi në minutën e 29, kurse skuadra pejane, pas kësaj humbje, edhe më tutje mbetet në garë të vështirë me skuadrat e tjera në fundin e renditjes për t'iu shmanjur zonës së rrezikshme. Prishtina mbetet tri pikë pas skuadrës lidere, Dritës.



## Liria - Llapi 1-2

Fitore mjaft të vlefshme arriti skuadra e Llapit, e cila e mposhti Lirinë në Prizren (1-2). Në pjesën e parë nuk u shënuar asnjë gol, kurse në pjesën e dytë mysafirët shënuan të parët nëpërmjet Mirlind Dakut (64), i cili, pas nxori penallti, arriti të shënojë gol. Golin e dytë e shënoi pas tetë minutave Mentor Zhdrella. Krejt çfarë arritën vendësit në këtë ndeshje ishte goli i nderit i shënuar nga Mevlan Zeka. Pas kësaj fitore skuadra e Tahir Batacinës mban gjallë shpresat për titull, ani pse ka tetë pikë më pak se Drita.

Ndërsa prizrenasit janë edhe më larg titullit kampionë. Në xhiron e radhës Llapi e pret Dritën e Gjilanit, kurse Liria i shkon Feronikelit në Drenas.

## Drenica - Flamurtari 2-0

Drenica pa ndonjë mund të madh e mposhti Flamurtarin (2-0) dhe në këtë mënyrë thaujse e ka siguruar edhe moszhvillimin e ndeshjes së barazhit. "Hero" i kuqezinjve nga Skenderaj ishte Denis Peposhi, i cili realizoi dy golat e fitores në minutën 72 dhe 90. Në xhiron e radhës Drenica luan në Pejë ndaj Besës, kurse Flamurtari e pret Vëllazninim.

### Vala SUPERLIGA

Trepça '89 - Vëllaznimi	3-0
Drita - Vllaznia (P)	2-0
Prishtina - Besa	1-0
Liria - Llapi	1-2
Drenica - Flamurtari	2-0
Gjilani - Feronikeli	0-0

### Tabela

1. Drita	53 pikë
2. Prishtina	50
3. Llapi	45
4. Liria	43
5. Trepça '89	43
6. Feronikeli	41
7. Gjilani	40
8. Drenica	39
9. Vëllaznimi	35
10. Besa	18
11. Flamurtari	15
12. Vllaznia	14

Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Trepça '89, Feronikeli-Liria, Llapi-Drita, Vllaznia-Prishtina, Besa-Drenica, Flamurtari-Vëllaznimi.

### LIGA E PARË

Vushtrria - Ramiz Sadiku	3-0
Trepça - Fushë Kosova	3-2
2 Korriku - KEK-u	1-2
Rahoveci - Kosova (P)	5-1
Dukagjini - Kika	1-0
Ferizaj - Hajvalia	2-1
Vitja - Bashkimi (K)	0-0
Onix - Ballkani	0-1

### Tabela

1. KEK-u	55 pikë
2. Ballkani	54
3. Vushtrria	52
4. Ferizaj	47
5. Onix	40
6. Fushë-Kosova	38
7. Dukagjini	32
8. Vitja	32
9. Bashkimi (K)	32
10. Ramiz Sadiku	32
11. 2 Korriku	30
12. Trepça	29
13. Rahoveci	26
14. Kika	24
15. Hajvalia	23
16. Kosova (P)	7

# Bashkimi mposhtet nga Levski në finale të Ligës Ballkanike

**SAMOKOV, 15 PRILL** - Levski Lukoil është shpallur kampion i Sigal Uniqa Ligës Ballkanike (BIBL) për edicionin 2017/18, pasi në finalen e luajtur të dielën në Samokov të Bullgarisë e ka mposhtur skuadrën e Bashkimit nga Prizreni me rezultat 83:72 (15:18, 27:19, 21:22, 20:13). Prizrenasit e nisën mjaft mirë ndeshjen duke e fituar çerekun e parë me 18:15, por më pas ekipi bullgar këndellet dhe në çerekun e dytë arriti të shkojë në pushim me avantazh prej 5 pikëve, 42:37. Në fakt,



prej çerekut të tretë e tutje ishte Levski që e diktoi ritmin e lojës dhe kështu arriti që deri në fund ta ruajë rezultatin dhe në fund të fitojë me 11 pikë epërsi. Bashkimi

pati disa momente të mira ndërmjet çerekut të tretë dhe të katërt, të cilat nuk mjaftuan për t'u shpallur në fund kampioni i Ligës Ballkanike. Më të merituarit për triumfin e Leveskit ishin Bozhidar Avramov me 21 pikë, Stanimir Marinov me 20 dhe Nemanja Miloseviq me 13 pikë e 7 kërcime. Në anën tjetër, te Bashkimi më të dalluarit ishin Frederic Stutz me 21 pikë e 8 kërcime, Aaron Mossi me 18 pikë, 8 kërcime e 6 asistime dhe Mikailë Imusiq me 15 pikë.

# PSV-ja, kampione e Holandës; City, i Anglisë

Eindhoven, 15 prill - PSV-ja ka mposhtur Ajaksin për ta siguruar titullin e radhës në Holandë, tri xhiro para fundit. Kampioni i ri holandez fitoi thellë 3 me 0 për titullin e radhës. Ky është titulli i tretë në katër vjetët e fundit për PSV Eindhovenin. Ndërsa të dielën titullin e kampionit e ka fituar edhe Manchester City. Skuadra e Pep Guardioliës iu gëzua këtij suksesi pasi West Bromwich Albion e mposhti në "Old Trafford" skuadrën e Manchester Unitedit (0-1).



# Derbi Milan - Napoli nuk solli fitues

**MILANO, 15 PRILL** - Ndeshja derbi e zhvilluar në "San Siro" në mes të Milanit dhe Napolit përfundoi në barazim pa gola 0-0. Milani mbetet shtatë pikë larg zonës së Ligës së Kampionëve,

gjashtë javë para fundit, ndërsa Napoli mbetet gjashtë pikë larg Juventusit kryesues. Pepe Reina, që në sezonin e ardhshëm do të jetë portieri i Milanit dhe Gigio

Donnarumma, që u bë futbollisti më i ri në historinë e Serisë A që arrin shifrën e 100 ndeshjeve, ishte lojtarët më të mirë në fushën e lojës, teksa shmangën golat në rastet e pakta që patën

dy ekipet, raporton "Telesport". Vlen për t'u përmendur aktivizimi për 90 minuta i futbollistit të kombëtares kuqezi Elseid Hysaj me Napoli. Ai mori karton të verdhë kur u mbush një orë lojë.



## Ricciardo triumfon në Kinë

SHANGAI, 15 PRILL - Daniel Ricciardo me Red Bullin ka triumfuuar në garën e Çmimit të Madh të Kinës në Formula 1, prova e tretë sezonale e Botërorit 2018, duke korrur suksesin e parë sezonal në pistën e Shangait, i gjashti në

karrierën e tij. Një paraqitje e shkëlqyer e pilotit australian, që përfitoi nga hyrja e makinës së sigurisë në pistë në mesin e garës, për t'i ndërruar gomat. Për pasojë, Ricciardo i kishte më të freskëta gomat në pjesën e

dytë të garës, duke nisur një seri parakalimesh, të gjitha fantastike, duke marrë kreun 10 xhiro nga fundi dhe fituar garën. Në vendin e dytë u rendit Valtteri Bottas me Mercedesin, ndërsa në të tretin u klasifikua Kimi

Raikkonen me Ferrarin. Sebastian Vetteli, që e nisi garën nga "pole", e mbylli atë në vendin e tetë, pas një kontakti me Verstappen dhe me makinën e dëmtuar, ndërsa Hamiltoni u klasifikua në vendin e pestë, në një garë



anonime dhe pa grintë për kampionin e botës në fuqi.

## 'Drini i Bardhë' i Hasit do të bëhet me fushë sportive

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, i shoqëruar nga deputeti Nezir Çoçaj, vizituan Klubin e Futbollit "Drini i Bardhë" në Gjonaj të Hasit. Ministri Gashi me kryesinë e klubit bisedoi për sfidat dhe problemet infrastrukturale me të cilat përballlet klubi hasjan me traditë shumëvjeçare. Mungesa e një fushe sportive për përgatitjen e lojtarëve, por edhe për zhvillimin e garave e të ndeshjeve si dhe organizimi i turneve ishte brengë e sportdashësve të këtij lokaliteti. Ministri u zotua se Ministria e Sportit dhe vetë ai do të angazhohen që gjatë këtij viti të fillojnë të investojnë në rregullimin e fushës sportive të fshatit Gjonaj. "Ministria do të investojë në Gjonaj, me qëllim që KF 'Drini i Bardhë' ta ketë hapësirën e



duhur për zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe aktivizimin e të rinjve të trevës së Hasit, e cila ka talente të jashtëzakonshëm e sportistë të dalluar", ka thënë ministri Gashi. Nërkaq, udhëheqësit e klubit dhe

futbollistët e mirëpritën zotimin e ministrit për të investuar në infrastrukturë në mënyrë që sportistët dhe të rinjtë hasjanë të kenë një vend të standardeve për të ushtruar e zhvilluar aktivitetet e tyre futbollistike.

## Golden State dhe Toronto e nisin me fitore

OAKLAND, 15 PRILL - Kampionati amerikan i basketbollit, NBA, ngriti siparin e fazës së "play-off"-eve. Skuadra kampione në fuqi, Golden State, tregoi menjëherë forcën e saj në përballjen me San Antonion, teksa fitoi ndeshjen e parë me tekantë 113-92. "Warriors"-at, edhe pse pa Stephen Curry, dominuan nga minuta e parë deri në fund. Klay Thompson ishte shënuesi më i mirë për skuadrën e Steve Kerrit, me 27 pikë, ndërsa Duranti shënoi 24 pikë.

Për San Antonion ata që u përpoqën më shumë ishin Rudy Gay, me 15 pikë, dhe Forbes e Aldridge, me nga 14 pikë. Philadelphia vazhdon të surprizojë në këtë sezon të NBA-së. "76ers" u rikthye në fazën e "play-off"-eve pas një kohe të gjatë, e u vu përballë Miami në raundin e parë të kësaj faze. Një sfidë, të cilën ajo e fitoi me rezultatin 130-103. Dy periodat e para u mbyllën me avantazhin e Miami Heatit, 60-56, por Philadelphia shpërtheu më pas duke e bërë të sajën këtë sfidë, ku spikatën Simmons me 17 pikë e 14 asistime, e Ilyasova me 17 pikë e 14 topa në tabelë, por



shënuesi më i mirë i sfidës ishte J. J. Redick me 28 pikë. Toronto hasi në probleme ndaj Washington Wizardsit por, në fund, arriti ta fitojë përballjen e parë me rivalin, me rezultatin 114-106, raporton "TopChannel". Në "Air Canada Center" fillimi i sfidës ishte më i mirë për Wizardsin, që fitoi pjesën e parë 59-55. Por, pas pushimit të sfidës, ishte Toronto që mori frerët e lojës në duar, duke e fituar përballjen. Sergi Ibaka rezultoi shënuesi më i mirë për "Raptors"-at, me 23 pikë, ndërkohë që rrëmbeu edhe 12 topa në tabelë. Delon Wright

shënoi 18 pikë, ndërsa DeRozan e mbylli ndeshjen me 17 pikë. New Orleans Pelicansi befasoi Portlandin në "Moda Center", teksa e mposhti me rezultatin 97-95, duke u bërë e vetmja ndeshje e këtij fillimi të "play-off"-eve ku faktori fushë nuk ndikoi aspak. Për New Orleansin, Anthony Davis ishte në një ditë të shkëlqyer dhe këtë e tregon bilanci i tij në këtë sfidë, me 35 pikë e 14 topa në tabelë, ndërsa Mirotiçi e mbylli sfidën me 16 pikë e 11 topa në tabelë. Mjaf mirë u shfaqën edhe Holiday, me 21 pikë, dhe Clarku, me 10 pikë, ndërsa Rajon Rondo e mbylli sfidën me 17 asistime.

### SHKURT

#### Besa fiton derbin dhe shkëputet në krye

Besa FamGas po vazhdon dominimin në hendbollin e Kosovës duke e fituar derbin e madh ndaj Prishtinës me shtatë gola dallim, 31:24. Me këtë fitore Besa thaujse e ka të sigurt pozitën e parë për "play-off". Udhëheq në tabelë me 48 pikë, katër më shumë se Prishtina që është e dyta.

Deri në fund të Superligës A kanë mbetur edhe tri xhiro të tjera. Ishte kjo përballja e katërt mes Besës e Prishtinës këtë edicion. Rezultati është 3:1 në të mirë të ekipit pejan, që është kampion aktual. Besa e fitoi pjesën e parë me dy gola dallim, 17:15. Pejanët ishin dominues edhe në pjesën e dytë dhe mbajtën epërsinë konstante. Prishtina tentoi të afrohet, por pa shumë sukses. Në fund rezultati ishte 31:24 në të mirë të Besës. Të shtunën u luajtën edhe dy ndeshjet e tjera të javës së 25-të të Superligës A. Drita fitoi ndaj Vëllaznimit me dy gola dallim, 36:34. Nderkaq, Kastrioti fitoi thellë ndaj Zhegrës me rezultat 34:16.

#### City kërkon Mbappen

Manchester City raportohet se ka bërë gati planet për ta transferuar Kylian Mbappen nëse del që Paris Saint-Germaini ka thyer rregullat e "Fair-Playit Financiar". Lajmi është bërë me dije nga "The Mirror". Mbappe ka pasur 38 paraqitje këtë sezon për PSG-në duke realizuar 19 gola dhe duke regjistruar 17 asistime.

#### Lëndohet Vidali

Nëse Real Madridi planifikon të fitojë për të tretën herë me radhë Ligën e Kampionëve, duhet që fillimisht ta eliminojë Bayern Munchen në gjysmëfinale. Kjo përballje mund të duket më e lehtë në letër, kur kuptohet se të dielën në stërvitje të Bayernit është lënduar Arturo Vidal. Kiliani ka lënë stërvitje me barelë, duke pësuar një lëndim në gju. Pikërisht ky lëndim ka bërë që Vidal të mos mund të paraqitet në ndeshjet e fundit. Shumë shpejt pritet që Bayerni të njoftojë për shkallën e lëndimit të Vidalit.

#### Ibra shënon golin e fitores për Galaxyn

Zlatan Ibrahimoviçi vazhdon të lë shenjën e tij në MLS. Sulmuesi suedez, që zbarkoi në Amerikë vetëm tri javë më parë, pas dy golave që realizoi në debutimin e tij me Los Anxhelos Galaxyn, ka realizuar një tjetër gol. Këtë herë ai ishte titullar në formacion për ekipin e tij dhe e ka "festuar" këtë gjë me një gol realizuar ndaj ekipit të Chicago Fire, ku luan Bastian Schweinsteigeri. Ndeshja përfundoi 1-0 për ekipin e LA Galaxyt dhe goli i Ibrahimoviçit ishte vendimtar (realizoi pas një krosi të Ashley Cole), pasi i dha tri pikët e radhës skuadrës së tij. Në tri ndeshje që ka luajtur në kampionatin amerikan, sulmuesi 36-vjeçar suedez ka arritur dy fitore dhe një humbje.

#### Neymari e pranon se kishte mosmarrëveshje me Cavanin

Pesë muaj pas mosmarrëveshjes famëkeqe në fushë në mes të Edinson Cavanit dhe Neymarit, ky i fundit e ka pranuar se ka ekzistuar një mospajtim mes tij dhe sulmuesit uruguaian se kush duhet t'i ekzekutojë penalltitë. "Njerëzit kanë folur për këtë duke e bërë të dukej diçka më e madhe sesa që ishte, edhe pse është e vërtetë se ka pasur tensione dhe fërkime me Cavanin. Por, e zgjidhem shumë shpejt këtë problem", ka thënë ai. Ai shpjegoi se si e kishin zgjidhur mosmarrëveshjen me Cavanin. "Tri ditë pas asaj që ndodhi, u ulem dhe biseduam. Duhej ta zgjidhnim personalisht, pa e përfshirë askënd tjetër. Mediet e kanë tepruar me të sepse kështu shesin më shumë, ato flasin gjëra që nuk duhet t'i thonë dhe kështu ndikojnë edhe në koncentrimin tonë", ka shtuar Neymarit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

## KONKURS

### 1. Departamenti i Statistikave Sociale një ( 1 ) pozitë te karrierës:

**Titulli:** Një ( 1 ) Zyrtar për Statistika të Arsimit

**Numri i referencës :** ASK-DSS-001

**Koeficienti :** 6

#### Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Grumbullimin e të dhënave të arsimit për arsimin para-universitar për shkollat nga komunitetet përfshirë arsimin publik dhe privat si dhe bënë kontrollimin logjik të tyre,
2. Angazhohet në grupin punues për implementimin e ISCED 2011;
3. Angazhohet në kontrollimin dhe përpunimin e të dhënave të popullsisë,
4. Mban takime sipas nevojës me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,
5. Merë pjesë në takime, trajnime, grupe punuese që kanë të bëjnë me statistikat e arsimit (të organizuara brenda dhe jashtë vendit),
6. Ofron mbështetje në përgatitjen e raporteve mbi arsimin dhe popullsinë,
7. Përgatitë raportet ditore të punës,
8. Kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorit te drejtpërdrejtë.

**Kualifikimi :** Diploma universitare nga fusha e Ekonomisë, Sociologjisë apo ndonjë fushë relevante të ngjashme.

**Përvoja e punës:** kandidati duhet te ketë 2 vite përvojë pune.

#### Kompetenca dhe aftësitë:

- Të ketë aftësi profesionale
- Njohuri mbi indikatorët social dhe në lëmin e arsimit,
- Shkathësi në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore të arsimit,
- Të ketë aftësi për të kryer kontrollimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave të statistikave të arsimit,
- Të ketë shkathësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- I/E vetë motivuar, fleksibil dhe i/e gatshëm të punojë nën presion,
- Njohuri të punës me kompjuter (Word, Excel, Access, SPSS, etj),
- Njohuri të gjuhës angleze.

### 2. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, dy ( 2 ) pozita të karrierës:

**Titulli:** Dy ( 2 ) Zyrtar në Zyrën Rajonale të Statistikës në Gjakovë

**Numri i referencës:** ASK-DRA-002

**Koeficienti:** 6

#### Detyrat dhe përgjegjësit:

1. Bënë shpërndarjen, distribuimin materialit në teren, grumbullimin materialit nga njësit raportuese, kontrollimin dhe sistemimin e anketës së bugjetit familjar,
2. Monitorimi dhe kontrollimi i raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të industrisë,
3. Monitorimi dhe kontrollimin e raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të ndërtimitarisë,
4. Shpërndan, plotëson, kontrollon dhe sistemon raportet mbi statistikat e arsimit (shkollave),
5. Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve tremujore të hotelarisë dhe turizmit,
6. Shpërndan, plotëson dhe kontrollon çmimet e konsumit të gjerë, shpërndan, plotëson dhe kontrollon çmimet e bujqësisë,
7. Zhvillon raporte të mira me respondentët, udhëzon plotësimin e formularëve të anketave statistikore si dhe bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore,
8. Kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorit te drejtpërdrejtë.

**Kualifikimi :** Diploma Universitare – Fakulteti nga fushat Ekonomike, Shoqërore, Juridike, apo të ngjashme.

**Përvoja e punës:** Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune.

#### Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e kompjuterit (Word, Excel, Outlook),
- Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore,
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale,
- Shkathësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

#### Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

#### Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

**Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.**

#### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zel Salihu" Nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës, vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkojnë për vendin e punës për të cilin konkurroni. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit në:

Nr. tel: 038-20031149, prej orës 08:00–16:00.

*"Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*

*"Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".*

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Kosovo Agency  
of Statistics

Na osnovu Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o  
Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Agjencia za Statistiku  
Kosova raspisuje:

## KONKURS

### 1. Odeljenje Socijalnih Statistika: jedna (1) pozicija od karijere:

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenik za statistiku obrazovanja

Referentni broj: ASK-OSS-001

Koeficijent : 6

Zadaci i odgovornosti:

1. Prikuplja podataka obrazovanja o preduniverzitetskom obrazovanju, za škole iz zajednica uključujući javno i privatno obrazovanje i njihovu logičku kontrolu,
2. Angažuje se u radnoj grupi za sprovođenje ISCED 2011,
3. Uključuje se u kontrolu i obradu podataka o stanovništvu,
4. Održi sastanke po potrebi sa Ministarstvom Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,
5. Učestvuje na sastancima, obukama, radnim grupama koje se bave statistikom obrazovanja (organizovane unutar i izvan zemlje),
6. Pruža podršku u pripremi izveštaja o obrazovanju i stanovništvu,
7. Priprema dnevne izveštaja o radu,
8. Obavlja i druge dodatne zadatke na zahtev direktnog nadređenog.

**Kvalifikacija :** Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije, sociologije ili relevantne oblasti.

**Radno iskustvo:** kandidat mora imati 2 godine radnog iskustva.

**Nadležnosti i veštine:**

- Da ima profesionalne veštine
- Znanje o socijalnim indikatorima i oblasti obrazovanja,
- Veštine u prikupljanju, obradu i analizu statističkih podataka obrazovanja,
- Veštine da vrši kontrolu, obradu i analizu statističkih podataka obrazovanja,
- Dokazane veštine pisane i usmene komunikacije,
- Samomitivisan/a, fleksibilan/a i spreman/a za rad pod pritiskom,
- Poznavanje rada na računaru (Word, Excel, Access, SPSS, itd),
- Poznavanje engleskog jezika.

### 2. Odeljenje Popisa i Anketa: dve (2) pozicije od karijere:

Naziv radnog mesta: Dva (2) Službenika Regionalne Kancelarije za Statistiku u Đakovici

Referentni broj: ASK-OPA-002

Koeficijent : 6

Zadaci i odgovornosti:

- 1: Vrši isporuku, distribuciju materijala na terenu, prikupljanje materijala iz izveštajnih jedinica, kontroliše i sistematizuje anketu o budžetu domaćinstava,
- 2: Prati i kontrolira kvartalne izveštaje kratkoročne statistike industrije,
- 3: Prati i kontrolira kvartalne izveštaje kratkoročne statistike izgradnje,
- 4: Distribuiraju, popunjavanje, kontroliše i sistematizuje izveštaje o statistici obrazovanja (škola),
- 5: Popunjavanje, nadgleda i kontroliše kvartalne izveštaje ugostiteljstva i turizma,
- 6: Distribuiraju, popunjavanje i kontroliše cene široke potrošnje, distribuiraju, popunjavanje i kontroliše cene u poljoprivredi,
- 7: Razvija dobre odnose sa ispitanicima, daje uputstva o popunjavanju obrazaca statističkih anketa, vrši kontrolu i logičku analizu statističkih istraživanja,
8. Obavlja i druge dodatne zadatke na zahtev direktnog nadređenog.

**Kvalifikacija:** Univerzitetska diploma- Fakultet u oblasti ekonomije, društvenih, pravnih nauka ili slično.

**Radno iskustvo:** kandidat mora imati 2 godine radnog iskustva.

**Nadležnosti i veštine:**

- Poznavanje rada na računaru (Word ,Excel,Outlook),
- Timski rad i saradnja su potrebna,
- Sposobnost da čuva tajnost individualnih statističkih podataka,
- Sposobnost da obavlja poslove i zadatke prema godišnjem planu Regionalne Kancelarije,
- Dobre veštine komuniciranja, uključujući sposobnost da tumači informacije, daje uputstva i prenosi informacije drugima.

### Procedura konkurisanja:

U Civilnoj Službi imaju pravo da budu zaposleni punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju potrebnu školsku spremu i profesionalne sposobnosti za sprovođenje administrativnih funkcija i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

### Zakoni i propisi kojima se reguliše zapošljavanje:

Izbor Civilnih Službenika vrši se u skladu sa Zakonom br . 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Uredbom . 02/2010 o Postupku za Zapošljavanje u Civilnoj Službi.

### Trajanje imenovanja:

U skladu sa Zakonom o Civilnoj Službi Republike Kosova u kojem je predviđen i period probnog rada u trajanju od jedne (1) godine.

### Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima.

### Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova , Ul."Zenel Salihu" br.4,Priština.

Uz aplikacije potrebno je priložiti i kopije dokumenata o kvalifikacijama, dokaz o radnom iskustvu, potvrdu suda da osoba nije pod istragom i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potreba za radno mesto za koju se prijavljujete. Zahtevi podneti nakon isteka roka konkursa neće biti prihvaćeni.

Nepotpune prijave će biti odbijene.

Zbog velikog broja primljenih prijava,samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati izabrani u uži izbor biće pismeno testirani i intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kadrovsku Kancelariju na broj telefona: 038- 200 31149 od 08:00 – 16: 00 časova.

“ Kosovska Civilna Služba pruža ravnopravnu mogućnost zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih nacionalnosti na Kosovu.”

“Ne-većinske nacionalnosti i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u centralnim i lokalnim organima civilne službe javne administracije, kako je specificirano u Članu 11, st. 3 Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova”.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kaltrina Dakaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoh banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkoh banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lfti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrek-tësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

### URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA

Në qendër të Prishtinës, kërkoh banesë me qira, për zyre. Hapësira 80-100m2.

Kati i -I- deri në katin -III-.  
Tel: 044741155

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërzhaliu ka shprehur dëshirën që t ashes një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërzhaliu.

### LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

**Urgjentisht kërkoh një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administratës Publike  
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

## KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

**Titulli i vendit të punës:**

Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (1).

**Paga mujore:** 1.171.17 € bruto.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Siguron këshilla të politikave për Ministrinë; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Ministrisë të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Ministrisë të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Ministrisë; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Ministrisë; menaxhon rrjedhën e informacionit në Ministrinë dhe koordinon raportet e Ministrisë me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përkrahimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të punës për këtë pozitë mund të gjeni në linkun <http://map.rks-gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfc3.aspx>

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimit e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedurat e konkurrencës:**

- Konkurrimi për pozitën e Sekretarit i Përgjithshëm është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e preferuar në fushat që ndërlidhen me punën e Ministrisë përkatëse.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Duhet të kenë shkathësi në përcaktimin dhe arrijtjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; njohuri bazike në programet e kompjuterit; standarde të larta të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë.
- Të ketë 8 vite përvojë pune profesionale prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njohjen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përgjithshëm do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Përzgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Mandati për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është 3 vjet.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetim apo i dënur për veprë penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
- Aplikuesit duhet të paraqesin: 1) një CV; dhe 2) një letër motivim me shpjegime të qarta dhe shembur nga përvoja profesionale që tregojnë se si përvoja dhe aftësitë e tyre përputhen me kërkesat e vendit të punës.

*"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."*

*Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 - 16:00.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administratës Publike  
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

## KONKURS

Na osnovu člana 15 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i člana 8 Uredbe br. 06/2010 o Proceduri imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje konkurs za sledeće radno mesto:

**Naziv radnog mesta:**

- Generalni Sekretar - Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo (1).

**Mesečna Plata:** 1.171.17 C bruto.

**Zadaci i odgovornosti:**

- Obezbeduje političke savete Ministru; obezbeduje da političke odluke i druge mere Ministarstva sprovedu efikasno i efektivno; obezbeduje da mere sprovođenja Ministarstva se redovno nadgledaju i da se preduzimaju neophodne mere za prevazilažavanje prepreka; upravlja civilnom službom i ostalim zaposlenima Ministarstva; upravlja financije i ostale izvore Ministarstva; upravlja tokom informacija u Ministarstva i koordinira izveštaje Ministarstva sa ostalim nadležnim organima administracije itd.
- Kopmpletan opis radnih zadataka i odgovornosti za ovu poziciju možete naći na dole navedenom linku <http://map.rks-gov.net/getattachment/911262db-0474-4480-859c-44d39f38fa9/.aspx>

**Uslovi učestvovanja regrutiranja su:**

- U Civilnoj službi, imaju pravo da se zapošljavaju svi državljani Republike Kosova koji su odraslog doba i koji imaju punu sposobnost delovanja; koji poseduju civilna i politička prava; koji poseduju neohodno obrazovanje i stručnu spremu za obavljanje ekzekutivnih zadataka, upravljanja ili sprovođenja administrativnih funkcija i da imaju fizičku sposobnost, koje su neophodne prema zakonu za dotičnu poziciju.

**Procedure konkursa:**

- Konkurs za poziciju Generalni Sekretar je otvoren i pravo konkurisanja imaju civilni službenici koji su u visoko upravnim pozicijama, upravnim pozicijama ili pozicija koji su podjednaki u javnim ili privatnim kompanijama.

**Zahtevano obrazovanje:**

- Diploma univerziteta (minimum 4 godine nakon srednje škole) ili više, poželjna iz oblasti koja su nadovezana sa dotičnim poslovima Ministarstva.

**Sposobnosti, iskustvo i ostala svojstva koja se zahtevaju :**

- Potrebno je posedovati sposobnosti za određivanje i postizanje strateških objekta institucije, kao i visoke sposobnosti organizovanja i upravljanja; odlične sposobnosti komuniciranja i sporazuma; dokazane sposobnosti za analiziranje stanja i predlog opcija; osnovno vladanje kompjuterskim programima; standarde visoka integriteta; poštovanja i pravde.
- Najmanje 8 godine radnog iskustva u profesiji, uključujući najmanje 5 godina upravnog nivoa.
- Poznavanje stranih jezika predstavlja prednost prilikom ravnopravnog vrednovanja kandidata.
- Obaveštavaju se aplikanti da će se vrednovanja bazirati na osnovu bližih detalja koji se nalaze u opisu radnog mesta.

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutiranje:**

- Izbor Generalni Sekretar se vrši u skladu sa Zakonom br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i Uredbe br. 06/2010 za Procedure Imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama Civilne Službe Republike Kosova i Uredbe br. 02/2010 za Procedure Rekrutiranja u Civilnoj Službi.

**Trajanje mandata :**

- Mandat za poziciju Generalni Sekretar je 3 godine.

**Datum zatvaranja konkursa:**

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.

**Podnošenje zahteva:**

- Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Ministarstvu Javne Uprave, kancelarija Personela, br. 320, III sprat, zgrada bivšeg Doma Štampe, Priština ili preko elektronske adrese kroz: <http://map.rks-gov.net>. U prilogu Aplikacije neophodno je da se dostave kopije dokumentacije o kvalifikaciji, za diplomirane u univerzitetima van zemlje treba da dostave dokaz o nostrifikiranju diplome; dokaz radnog iskustva; dokaz da nije pod istragom ili kažnjavanje za krivično delo (koja ne sme biti starija od datum proglašavanja ovog konkursa) i druga dokumentacije koja se zahtevaju za apliciranje za pomenuto radno mesto.
- Aplikanti treba da dostave: 1) jedan CV- u i 2) jednu pismo motivacije uz jasno objašnjenje i primere profesionalne iskustva koje pokazuje kako iskustvo i sposobnosti poklapaju sa zahtevima radnog mesta.

*"Civilna Služba Kosova pruža ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i očekuje aplikacije od strane oba pola i članova svih zajednica na Kosovu."*

*Nevećinske Zajednice i njihovi pripadnici imaju jednako i proporcionalno pravo predstavljanja u organima Civilne Službe centralne i lokalne administracije, kao što je naglašeno članom 11, stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova."*

- Zahtevi nakon određenog dana yatvaranja konkursa se neće ne primati. Ne kompletirana dokumentacija se također neće primati.
- U slučaju velikog broja prijema zahteva, kontaktiraće se samo kandidati koji su izabrani za uži krug. Kandidati koji su izabrani i pozvani na intervju, potrebno je sa sobom da donesu originalne dokumente radi verifikacije.

Za detaljne informacije, možete se obratiti gđi. Sala Shala br. tel: 038-20030620, između 08:00 - 16:00 časova svakog radnog dana.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Divizioni për Komunikim me Publikun  
Divizija za Javno Komuniciranje  
Division of Public Communication

### THIRRJE PËR APLIKIM

#### Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për tremujorin e parë (TM1) 2018

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdojë të mbështesë sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër dhe therrjet e raportuara të gjedhit.

#### Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Të jenë të regjistruar në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Ta kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikat grumbulluese të qumështit, të pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- T'i dorëzojë më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar sipas cilësisë, në qumështore ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë nga banka për pagesën e bërë nga qumështorja për sasinë e dorëzuar;
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit";
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-se (vetëm për personat juridik)
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

#### Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrate me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë 0.06 €
2. Klasa e Parë 0.04 €
3. Klasa e Dytë 0.02 €

#### Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – therrjet e raportuara të gjedhit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara nga AUV në kategorinë A, B, C dhe D
- Të raportojnë therrjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit të AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjedhet duhet të jenë të matrikuara me matrikull të Republikës së Kosovës;

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit/subjektit;
- Kopjen e licencës së lëshuar nga AUV-ja;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë/vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Regjistrin e kafshëve të therura, të lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit-AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së theruar;
- Dëshminë/fletëpagesën, me të cilën vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja tek fermeri, në vlerë prej 30 €/krer gjedhe të therur.

#### Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa do të bëhet për krerë gjedhe të therur, në vlerë prej 50 €/krer.
- Pagesës në vlerë prej 50 euro/krer u bëhet thertoreve përfituese;
- Thertoret obligohen që vlerën e mjeteve prej 30 euro t'ia paguajnë fermerit në momentin e therrjes së gjedhit. Ndërsa, vlera e mjeteve prej 20 euro i mbetet thertores për shërbimin e therrjes.

#### Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

